



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1248/7 prot.

Datë 01.07.2024

V E N D I M
Nr.776/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.07.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes, për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Luca” SHPK, dhe “Kevin Konstruksion” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-04512-05-13-2024 me objekt “Rikonstruksion i Gjimnazit ‘Skënderbeu’, Has”, me fond limit 97,431,542 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.05.2024 nga autoriteti kontraktor Bashkia Has.

Modifikimi i dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit “E hapur” me nr. REF-04512-13-2024 me objekt “Rikonstruksion i Gjimnazit ‘Skënderbeu’, Has” me fond limit 97,431,542 lekë pa TVSH parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.05.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Has.

Ankimues:

“Luca” SHPK, me NIPT K29824105N dhe me adresë: Elbasan, Perparim FATISH, Ndërtesa pranë kantierit të prodhimit të materialeve inerte, Peqin.

Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, me NIPT K71401004W dhe me adresë: Rruga “Adem Jashari”, Nd.4, Hyrja 10, Nj. Bashkiake nr.5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Has me adresë: Sheshi “Dëshmorët e Hasit”, Qyteti Krumë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre, duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.05.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur” me nr. REF-04512-05-13-2024, me objekt “Rikonstruktion i Gjimnazit ‘Skënderbeu’, Has” me fond limit 97,431,542 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.05.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Has.

II.2. Në datën 20.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4101 datë 20.05.2024 dhe nr. 1248/2024 prot., datë 20.05.2024, e operatorit ekonomik “Luca” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me datë 24.05.2024, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike, vendimin e shqyrtimit të ankesës, i cili u protokollua me tonën me nr. 1248/2 prot., datë 27.05.2024, me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për procedurën me objekt: “Kthim - përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Gjimnazit ‘Skenderbeu’ Has”, ku konstatohet, se ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vëren se,

Në lidhje me pretendimet e Ankuesit për këtë pikë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilët përcaktohet:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar

përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Proçedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe proçedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në Licencën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës. Konkretisht llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Sipas VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe proçedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, janë dhene përkufizimet si vijon: N.P. 1 Punime gërmimi në tokë Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

N.P. 2 Ndërtime civile e industriale Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse. N.P. 7: Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë

ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. N.S – 8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara N.S- 9 Punime strukturore speciale Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshtirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidimin e terreneve.

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rëlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Po analizojmë kategoritë e atakuara në ankesën e operatorit ekonomik përse I përket nivelit të klasifikimit të licencave në fushën e zbatimit, si më poshtë:

N.P. Ndërtime civile industriale	2 e	Shtrese b/a, C20/25, t=10cm "F.V hekur betoni periodik $\phi \div 10\text{mm}$, (per sheshin trotuar, shkallet, murin dhe stolat)" F.V bordura , betoni 15X25cm (struktura te holla) Shtrese betoni nen bordura, C6/10 Shtrim me pllaka guri Mbjellje bari ne lulishte Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III F.V. Fidane Peme dekorative F.V konstruksione metalike te perbera (porte e jashtme metalike+kangjella) Boje vaji mbi siperfaqe metalike (dy duar) Mur Betoni C20/25 Shtrese parket druri + shtrese niveluse + plintusa Vizime me boje ne fushat sportive (parket) Suvatim I mureve te jashteme h = mbi 4m	53,107,335	Kategoria C
---	--------	--	------------	----------------

<p><i>Suvatim I mureve te jashteme h = der 4m</i></p> <p><i>Suvatim me suva grafiato</i></p> <p><i>Hidroizolim me nje flete guajne 4mm + prajmer</i></p> <p><i>Suvatim I mureve te brendeshme h = mbi 4m</i></p> <p><i>Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah</i></p> <p><i>Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25</i></p> <p><i>Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjete + suva.</i></p> <p><i>Patinim i mureve brenda me allçi (stuko)</i></p> <p><i>Lyerje brenda me Boje hidroplastike cilesi e pare</i></p> <p><i>Korimano metalike tip kangjella dekorative perfshi lyerjen</i></p> <p><i>Hijezaes te jashtem alumini ne fasade</i></p> <p><i>Veshje me pllaka qeramike ne nyje sanitare</i></p> <p><i>Plintusa me pllaka gres</i></p> <p><i>F.V.Dyer druri MDF me kase derrase</i></p> <p><i>F.V.Dyer duralumini 1/2 xham ne nyje sanitae</i></p> <p><i>F.V.Dritare duralumini me xham dopio</i></p> <p><i>Lyerje tavane me boje hidromat vetajroses</i></p> <p><i>Lyerje muret e brendeshme me boje plastike Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar me tjegulla vendi</i></p> <p><i>Ulluk shkarkimi vertikal me baker</i></p> <p><i>Ulluk shkarkimi horizontal me baker 33cm</i></p> <p><i>Kasete shkarkimi</i></p> <p><i>Shtrese lluster cemento per nivelim 1:2</i></p>		
--	--	--

	<p><i>Shtrese me pllaka porcelanat</i></p> <p><i>plintues pllaka grez</i></p> <p><i>Veshje me pllaka gress porc. muret ËC</i></p> <p><i>Shtrese me pllaka mermeri hyrja e shkollës</i></p> <p><i>Shtrese me pllaka mermeri ne shesh pushime t=2cm</i></p> <p><i>"Hidroizolim ËC me dy shtresa mapej - ose ekuivalent me të në - dysHEME + muret</i></p> <p><i>Etj.</i></p>		
<p>N.P. 7:</p> <p>Ujës-jellës, gazsjellës, vajs-jellës, vepra kullimi e vadtje</p>	<p><i>F.V Tubo PE - HD Ø 75x6.8 mm, PN16</i></p> <p><i>F.V Rakorderi (bryla, ti, reduksion, etj)</i></p> <p><i>F.V Valvol nderprerese me sferë DN 65 (2½")</i></p> <p><i>F.V Fiter uji me rrjete DN 65, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Mates uji DN 65, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Valvol moskthimi DN 65, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Tubo PE - HD Ø 75x6.8 mm, PN16</i></p> <p><i>F.V Tubo PE -Xa, DN 50 (Ø63 X 8.6) mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PE -Xa, DN 40 (Ø50 X 5.9) mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PE -Xa, DN 32 (Ø40 X 5.5) mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PE -Xa, DN 25 (Ø32 X 4.4) mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PE -Xa, DN 20 (Ø25 X 3.5) mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PE -Xa, DN 15 (Ø20 X 2.8) mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PE -Xa, DN 12 (Ø16 X 2.2) mm</i></p> <p><i>F.V Rakorderi PE-Xa (bryla, ti, reduksion, etj)</i></p> <p><i>F.V Termoizolim armoflex per tubo PE-Xa, DN15 (Ø20 X 2.8) mm</i></p> <p><i>F.V Termoizolim armoflex per tubo PE-Xa, DN12 (Ø16 X 2.2) mm</i></p>	22,202,962	Kategoria B

<p><i>F.V Minivalvula nderprerese per pajisjet sanitare Ø 1/2"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 3"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 2½"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 2"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 1½"</i></p> <p><i>F.V Valvol nderprerese me sferë DN 65 (2½")</i></p> <p><i>F.V Valvol nderprerese me sferë DN 40 (1½")</i></p> <p><i>F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d110</i></p> <p><i>F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d75</i></p> <p><i>F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d50</i></p> <p><i>F.V Bryla RAU - PP d110 α = 45°</i></p> <p><i>F.V Bryla RAU - PP d50 α = 45°</i></p> <p><i>F.V Reduksion RAU - PP d110/d75</i></p> <p><i>F.V Manikota RAU - PP (HTU) d125</i></p> <p><i>F.V Manikota RAU - PP (HTU) d110</i></p> <p><i>F.V Manikota RAU - PP (HTU) d75</i></p> <p><i>F.V Manikota RAU - PP (HTU) d50</i></p> <p><i>F.V Brag 45° d125/110</i></p> <p><i>F.V Brag 45° d110/75</i></p> <p><i>F.V Brag 45° d75/50</i></p> <p><i>F.V Tubo shkarkimi PE d125</i></p> <p><i>F.V Tubo shkarkimi i rrullsur PEHD d160</i></p> <p><i>F.V Tubo shkarkimi i rrullsur PEHD d200</i></p> <p><i>F.V Tubo shkarkimi i rrullsur PEHD d250</i></p>		
--	--	--

	<p><i>"F.V Rakorderi per tuba PEHD (Bryla, reduksione, braga, manikota, etj.)"</i></p> <p><i>Pusete shkarkimi b/a, 50 x 50 cm, h = 100 cm</i></p> <p><i>F.V Pilete Ø110 per shkarkimin e ujrave te tarraces</i></p> <p><i>F.V Varange Ø110 per shkarkimin e ujrave te tarraces</i></p> <p><i>F.V Tubo GMX shkarkimi Ø 110 mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 125 mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 160 mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 200 mm</i></p> <p><i>F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 250 mm</i></p> <p><i>F.V Element ndihmes dhe rakorderi per tuba PEHD</i></p> <p><i>F.V Tubo i rrudhosur (CORRUGATED), I perforuar 220o per drenazhimin e ujrave nentokesore te themeleve. D 250mm, SN8 i kompetuar me te gjithë aksesoret</i></p> <p><i>"F.V Rezervuar zingato per furnizimin me uje, kapaciteti 5 000 lit,</i></p> <p><i>De=1600 mm, H=2660 mm, lidhjet 1¼"."</i></p> <p><i>"F.V Grupi i furnizimit me uje + paneli elektrik (INVERTER)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>- Prurja: 19 m³/h,</i> <i>- Prevalenca: 60 mKH2O,</i> <i>- Fuqia elektrike: 2x5.5 kË, rryma 2x10 A,</i> <i>- Ushqimi: 3F/400V/ 50Hz,</i> <i>- Lidhjet: DN 65, PN 16</i> 		
--	---	--	--

	<p><i>E kompletuar me te gjithë aksesoret e nevojshem."</i></p> <p><i>"F.V Autoklave 500 l</i></p> <p><i>Presioni max. i punes: 16 bar</i></p> <p><i>Presioni i ngarkimit: 1.5 bar</i></p> <p><i>Kapaciteti: 500 lit</i></p> <p><i>Diametri: 650 mm</i></p> <p><i>Lartesia: 1865 mm</i></p> <p><i>Lidhjet: 1¼" (DN 32)"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 3"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 2½"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 2"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1½"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1¼"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø ¾"</i></p> <p><i>F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø ½"</i></p> <p><i>F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 3" x 13 / 20 mm, per dy tipe termoizolimesh brenda / jashte, te veshura me flete PVC (brenda) dhe me flete alumin (jashte)</i></p> <p><i>F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 2½" x 13 / 20 mm, per dy tipe termoizolimesh brenda / jashte, te veshura me flete PVC (brenda) dhe me flete alumin (jashte)</i></p> <p><i>F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 / 20 mm, per dy tipe termoizolimesh brenda/jashte, te veshura me flete PVC (brenda) dhe me flete alumin (jashte)</i></p>		
--	--	--	--

<p><i>"F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me flete PVC"</i></p> <p><i>"F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1¼" x 13 mm, i veshur me flete PVC"</i></p> <p><i>"F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1" x 9 mm, i veshur me flete PVC"</i></p> <p><i>"F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø ¾" x 9 mm, i veshur me flete PVC"</i></p> <p><i>"F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø ½" x 9 mm, i veshur me flete PVC"</i></p> <p><i>"F.V Tub Cu te perkulshem me termoizolim Ø 14 x 1.0 mm, UNI EN 1057"</i></p> <p><i>"F.V Tub Cu te perkulshem me termoizolim Ø 12 x 1.0 mm, UNI EN 1057"</i></p> <p><i>F.V Rakorderi bakri (bryla ,ti, reduksioine etj)</i></p> <p><i>F.V Elektroda saldimi bronxi - lidhje argjendi L - Ag5</i></p> <p><i>F.V Paste deoksiduese per saldim (kuti - 250 gr)</i></p> <p><i>F.V Grupi i mbushjes automatike</i></p> <p><i>F.V Oxhaku - Shtrese lesh xhami me trashesi 25 cm</i></p> <p><i>"F.V Kanal i tymrave me llamarine çeliku, mbi shtresen izioluese 250/300 mm"</i></p> <p><i>F.V Kolektoret e dergim / kthimit Øe 114.3 mm (Ø 4")</i></p> <p><i>F.V Valvul flutur DN 80, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Valvul flutur DN 65, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Valvul flutur DN 32, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Valvol moskthimi DN 80, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Valvol moskthimi DN 65, Pn 6 bar</i></p>		
--	--	--

<p><i>F.V Filter uji me rrjet DN 80, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Filter uji me rrjet DN 65, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Xhunto antivibruese DN 80</i></p> <p><i>F.V Xhunto antivibruese DN 65</i></p> <p><i>F.V Valvul sigurie DN 25, Pn 6 bar</i></p> <p><i>F.V Valvul mishelatriçe tredegese DN 65</i></p> <p><i>F.V Termometer (0÷120°)</i></p> <p><i>F.V Manometer</i></p> <p><i>F.V Ajernxjerres automatik</i></p> <p><i>F.V Presostat sigurie</i></p> <p><i>F.V Flusostat DN80</i></p> <p><i>F.V Sensor temperature</i></p> <p><i>F.V Sensor i temperatures se ambientit te jashtem</i></p> <p><i>F.V Kabell transmetimi (2 x 1.5) mm²</i></p> <p><i>F.V Rregullator klimatik elektronik me mikrorocesor</i></p> <p><i>"F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 3"" x 3.65 mm, me mberthime Victaulic"</i></p> <p><i>"F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2½"" x 3.25 mm, me mberthime Victaulic"</i></p> <p><i>"F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2"" x 3.25 mm, me mberthime Victaulic"</i></p> <p><i>"F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 1½"" x 2.90 mm, me mberthime Victaulic"</i></p> <p><i>F.V Valvol nderprerese me sferë DN 40 (1½")</i></p>		
---	--	--

	<p><i>"F.V Rakorderi çeliku i zi (Bryla,Ti, reduksione etj). Mberthimi i rakorderive do te behet me kapje Victaulic"</i></p> <p><i>F.V Mberthime te rakorderive me kapje Victaulic</i></p> <p><i>F.V Hidrant zjarri Kodi Al - 5212</i></p> <p><i>F.V Fikëse zjarri me karrel Kodi Al - 5243</i></p> <p><i>F.V Fikëse zjarri me pluhur Kodi Al - 5204</i></p> <p><i>F.V Fikëse zjarri me CO2 Kodi Al - 5206</i></p> <p><i>F.V Buton sinjalizimi i zjarrit Kodi Al - 5102</i></p> <p><i>F.V Lidhja me motopompen Kodi Al - 5121</i></p> <p><i>F.V Zbritje shkalle Kodi Al - 5103</i></p> <p><i>F.V Rrezik zjarri nga pajisjet elektrike nën tension</i></p> <p><i>F.V Ndalim i shuarjes së zjarrit me uje</i></p> <p><i>F.V Dalje emergjence</i></p> <p><i>F.V Drejtim i daljes së emergjences Kodi Al – 5107</i></p> <p><i>"F.V Pomp e mbrojtjes kunder zjarrit Fuqia e instaluar (2x3) kE, In =2x10.2 A, 3F- 400V-50Hz</i></p> <p><i>- Prurja (21.6) m³ / h, Prevalenca 50 mkH2O</i></p> <p><i>- Presioni punes 6 bar, presioni max 16 bar Aksesoret</i></p> <p><i>Kolektori i dergimit 2½", me flanaxha PN 16 - cope 1</i></p> <p><i>Kolektori i thithjes 2½", me flanaxha PN 16 - cope 1</i></p> <p><i>Valvol nderprerese me farfalle, gize, PN16, DN 65 - cope 5</i></p> <p><i>Valvol moskthimi, me kllape, flanaxhe PN16, DN 65 - cope 2</i></p> <p><i>Xhunto elastike DN 65 - cope 2</i></p>		
--	---	--	--

	<p><i>Suporte antivibrues - cope 2 Manometer - cope 2</i></p> <p><i>Manovutometer - cope 2 Presotat per çdo pompe - cope 2</i></p> <p><i>Serbator me mebrane 20 lit , PN 10 - cope 1</i></p> <p><i>Kuader komande e kontrolli per çdo pompe - cope 1"</i></p> <p><i>Etj.</i></p>		
N.S- 9 Punime strukturore speciale	<p><i>F.V Elemente fiksues ne mur</i></p> <p><i>Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah</i></p> <p><i>Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25</i></p> <p><i>Mur Betoni C20/25</i></p> <p><i>Etj.</i></p>	21,760,230	Kategoria B

Autoriteti Kontraktor ka pranuar pjesërisht kërkesën e shoqërisë “Luca” sh.p.k. duke modifikuar kërkesat për kualifikim, konkretisht do të modifikohen kategoritë NP 1 – A, NS 8-A, NS 18 – A. Ky ndryshim do të reflektohet në Dokumentet Standarde të Tenderit nëpërmjet hartimit të shtojcës për modifikimin e kërkesave për kualifikim.

Sa i takon pretendimet të ankuesit se:

2.Pika 2.3.3 Disponimin për periudhën e 3 muajve të fundit të një numri prej 100 punonjësish. Ky kriter kualifikimi kërkon që operatori ekonomik të disponojë në listepagesë për periudhën e 3 muajve të fundit një numër prej 100 (njëqind) punonjësish. Ky kriter jo vetëm që është diskriminues dhe kufizues konkurrencë por është dhe i paargumentuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga një mbledhje aritmetike kërkesave për staf të kualifikuar dhe mbështetës të bërë nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet Standarde të tenderit konkludohet që numri i punonjësve i nevojshëm për realizimin e punimeve është 41 (dyzet e një) punonjës. Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar në asnjë rast se për çfarë duhen një diferencë prej 59 (pesëdhjetë e nëntë) punonjësish dhe nuk ka pasqyruar dhe bashkangjitur në dokumentet e tenderit. Vëmë në dijeni autoritetin kontraktor se caktimi I numrit të përgjithshëm të punonjësve që nevojiten për realizimin e punimeve në objektin e prokurimit është rezultat i analizës teknike të zerit të reventivit ku specifikohen orët e punës për fuqinë punëtore, të nevojshme për realizimin e një njesie volume, e shumëfishuar kjo me volumnin total të parashikuar si dhe bazuar në orët e punës ditore deri në përfundimin e afatit të punimeve dhe si rezultat përfitohet numri i nevojshëm i fuqisë punëtore që nevojitet për realizimin e plotë të punimeve në përputhje me grafikun e punimeve Nisur nga sa përshkruam me sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri dhe caktimin e një numri punonjësish në numër më shumë se 50 (pesëdhjetë).

Në lidhje me pretendimet e Ankuesit për këtë pikë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Pikë së pari, ky kriter është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77 pika 4 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar).

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listepagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Autoriteti Kontraktor ka pranuar pjesërisht kërkesën e shoqërisë “Lluca” sh.p.k. duke ulur numrin e kërkuar për fuqinë punëtore në 90 persona. Ky ndryshim do të reflektohet në Dokumentet Standarde të Tenderit nëpërmjet hartimit të shtojcës për modifikimin e kërkesave për kualifikim.

Vendosja e kriterit për një punësim mesatar prej të paktën 90 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në kater elementet e struktues se koston (material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve / makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Nga llogaritja e oreve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të cmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si më poshtë:

Total ore pune= 224,640 ore (sipas zërave të preventivit)

Ore/1 dite pune= 8 ore

Total Dite pune puntori= 224,640 ore/8 ore= 28,080 dite pune
Dite pune gjithesej= 12 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 26 dite= 312 dite
Numri i fuqise puntore = 28,080 dite/312 dite= 90 punetor.

Ne menyre te permbledhur numri i fuqise puntore qe kerkohet per realizimin e punimeve eshte: 224,640 ore / 8 ore pune ne dite/ 312 dite pune= 90 punetor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të Nenit 101 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, komisioni i shqyrtimit të ankesave i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës.

VENDOSI:

1. Të pranoj pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Lluca” sh.p.k. duhe hartuar nje shtojce për modifikimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit. 2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të AK”

II.5. Në datën 20.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4102 datë 20.05.2024 dhe nr. 1249 prot., datë 2024, e operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.7. Më datë 21.05.2024, me nr. 1249/2 prot., operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, ka paraqitur pranë KPP, të njëjtën ankesë përmes shërbimit postar.

II.8. Me datë 24.05.2024, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike, vendimin e shqyrtimit të ankesës, i cili u protokollua me tonën me nr. 1249/2 prot., datë 27.05.2024, me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për procedurën me objekt: “Kthim - përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruktion i Gjimnazit ‘Skenderbeu’ Has” ku konstatohet, se ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë:

“[...]

Sa i takon pretendimit të ankuesit se: 1) Ne kriteret e veçanta te kualifikimit eshte kerkuar: 1. 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë: Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 100 (Njëqind) punonjes duke përfshire dhe stafin teknik, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

3. Sic duket qarte, argumenti se perse duhet nje numer kaq ekstreme per realizimin e objektit eshte futja kot, pasi autoriteti thjesht referon disa nene, por pa argumentuar ne baze te nje analize grafike. Ne e dim se autoriteti kontraktor eshte bosi qe vendos kriteret por jo duke e trajtuar buxhetin e shtetit sikur te ishte prone private. Shoqeria jone gjykon, se kriteret per kualifikim vendosen qe ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe jo te vendose kerkesa te pa argumentuara dhe qe realisht nuk i shërbejnë realizimit me sukses te objektit te prokurimit. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me Lpp-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të Lpp-së.

10. Bazuar në sa më sipër, shoqeria jone gjykon se referuar vlerës së kontratës, natyrës së punes si dhe faktit se puna nuk do kryhet ne nje kantier dhe jo ne disa kantiere ndertimi nuk del nevojshme qe operatorët ekonomikë të disponojnë nje staf kaq te madh pasi edhe ne nje kantier nuk mund te punojne nje numer kaq i madhe punonjesish, qe në rastin konkretë duhet të jetë i konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës nje numer prej 30 punonjesish dhe keto ne profile te ndryshme sipas punimeve. Shoqeria jone gjykon se përcaktimi i numrit të punonjësve, duhet të vijë pas një analize të hollësishme të të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra, grafiku i lëvrimit, afati i kontratës dhe mundësisë së mobilizimit të punonjësve në orare të caktuara, sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi.

11. Sa më sipër, bazuar në të gjithë elementët e cituar më lartë, shoqëria jone gjykon se, kërkesa për disponimin e 100, është një kërkesë teresisht e pajustificuar nga autoriteti kontraktor. theksojme se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e operatorëve ekonomikë, por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithpërfshirëse të autoriteti kontraktor, i të gjithë elementëve të cituara më sipër, me qëllim përcaktimin e numrit të punonjësve, në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, si dhe në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të Lpp-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në SPE, aktit mbi argumentimin e kriterëve kualifikuese të procedurës së prokurimit objekt ankimi, rezulton që autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për disponimin e një numri kaq ekstrem punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore.

12. Per me teper, qe ne piken 2.3.3, shkronja b) te Kriterëve te Veçanta te Kualifikimit, autoriteti kontraktor ka specifikuar numrin e punonjesve 30 sipas specialiteteve qe duhen per punimet objekt prokurimi. Në këtë kuptim, kerkojme nga autoriteti kontraktor te modifikojë kriterin e mësipërm duke ulur numrin e punonjësve të kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës objekt shqyrtimi.

Në lidhje me pretendimet e Ankuesit për këtë pikë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Pikë së pari, ky kriter është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77 pika 4 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar).

Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listepagesat me këtë

kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Autoriteti Kontraktor ka pranuar pjesërisht kërkesën e shoqërisë “Kevin Konstruksion” sh.p.k. duke ulur numrin e kërkuar për fuqinë punëtore në 90 persona. Ky ndryshim do të reflektohet në Dokumentet Standarde të Tenderit nëpërmjet hartimit të shtojcës për modifikimin e kërkesave për kualifikim.

Vendosja e kriterit për një punësim mesatar prej te paktën 90 persona duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në kater elementet e struktureve se kostos (material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve / makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. Nga llogaritja e oreve të punës për të gjithë zerrat e punimeve të preventivit sipas manualit të cmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si më poshtë:

Total ore pune= 224,640 ore (sipas zerave të preventivit)

Ore/1 dite pune= 8 ore Total Dite pune puntori= 224,640 ore/8 ore= 28,080 dite pune

Dite pune gjithesej= 12 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 26 dite= 312 dite

Numri i fuqisë punëtore = 28,080 dite/312 dite= 90 punëtor.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohej për realizimin e punimeve është: 224,640 ore / 8 ore pune në ditë/ 312 dite pune= **90 punëtor**

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

II) Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar: 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në Licencën e shoqërisë të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet / Topograf 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist 1 (një)

➤ *Inxhinier Hidroteknike 1 (një)*

➤ *Arkitekt 1 (një)*

➤ *Inxhinier mekanik 1 (një)*

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Eshtë kërkuar të ketë në staf edhe inxhinier ndërtimi, Profili Strukturist i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve. Zerat e punimeve të parashikuara për tu realizuar kërkojnë njohuri specifike të kualifikuara për realizimin e strukturave beton dhe beton arme. Për këtë arsye është e nevojshme mbikqyrja e punimeve dhe marrja e masave inxhinierike të nevojshme për mbarevajtjen e punimeve.

17. Shoqeria jone konstaton se kjo kërkesë për kualifikim është argumentuar nga ana e autoritetit kontraktor mbështetur në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publikë dhe nenit 39, pika 6/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikë, por autoriteti kontraktor ka deshtuar të mirëargumentojë nga ana teknike lidhur me nevojën që ka autoriteti kontraktor që ofertuesi të ketë në stafin e tij personel krahas Inxhinierit të Ndërtimit edhe Inxhinier Strukturist.

18. Gjithashtu, shoqeria jone konstaton, se kërkesa që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij Drejtues Teknik ne Licence dhe një inxhinier strukturist nuk është në përputhje me projektin dhe natyrën e punimeve të përcaktuara në zërat e preventivit, pasi nga shqyrtimi i këtij dokumenti (preventivi) nuk konstatohet që ka zëra punimesh për të cilat kërkohet prezenca e inxhinierit të ndërtimit të profilit strukturist.

19. Për më tepër, shoqeria jone konstaton, se ne argumentimin e kriterëve, autoriteti kontraktor ka nxjere qarte se Inxhinieri i Ndërtimit do të mbulojë kontrollin e të gjitha punimeve në objekt: është kërkuar Inxhinier Ndërtimi, pasi projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e gërmimit, punimet e konstruksionit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, suvatimet, hidroizolimet, sistemimet e jeshtme etj. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

20. Për sa më sipër, shoqeria jone gjykon, se kërkesa që operatorët ekonomik ofertues të ketë në stafin e tyre Drejtues Teknik edhe 1 (një) drejtues teknik të profilit strukturist, nuk është e argumentuar nga ana teknike dhe nuk është në përputhje me objektin e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet që të heqë përcaktimin lidhur me disponimin nga operatorët ekonomik të 1 (një) drejtuesi teknik të profilit strukturist.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me pretendimin e ankuesit arsyeton si më poshtë:

Ky kriter është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, pasi me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtrahet: Eshtë kërkuar krahas Inxhinier Ndërtimi edhe Inxhinier Ndërtimi, Profili Strukturist, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve. Zërat e punimeve të parashikuara për t’u realizuar kërkojnë njohuri specifike të kualifikuara për realizimin e strukturave beton dhe beton arme, konkretisht:

- bordura, betoni 15X25cm (struktura te holla)
- Shtrese betoni nen bordura, C6/10 - Puseta betoni (60 x 60) cm, me kapak gize
- Mur Betoni C20/25
- Prishje strukturave ekzistuese betony
- Prishje struktura betoni B/A

Duke marr për bazë natyren dhe karakterin e punimeve të parashikuara për tu realizuar referuar preventivitt ë publikuar në SPE është e domosdoshme që në vijimësi të realizimit të punimeve të ndiqen nga personel i kualifikuar drejtues teknik inxhinier të profilizuar në mbarëvajtjen dhe drejtimin e punimeve të kategorizuara në natyren dhe kompleksitetin e tyre. Për këtë arsye është e nevojshme mbikqyrja e punimeve dhe marrja e masave inxhinierike të nevojshme për mbarevajtjen e punimeve nga inxhinier ndertimi profili strukturist.

Për sa më sipër, ky pretendim i ankimesit nuk qëndron.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

III) Ne kriteret e veçanta te kualifikimit eshte kerkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 30 (Tridhjetë) punonjes të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore,

Certifikate trajnimi (të vlefshme), ose Deshmi Profesionale lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë për të pakten 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Teknik Ndertimi 1 (nje)
- Hidraulike 3 (tre)
- Elektriçiste 4 (kater)
- Saldator 2 (dy)
- Bojaxhi 4 (kater)
- Murator 3 (tre)
- Pllakashtrues 4 (kater)
- Hidroizolues 3 (tre)
- Shofer 4 (kater)

Shoferet për drejtim mjetesh duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të pakten: - 3 (tre) Manovratore / Eskavatoriste / Automakinist, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontrate pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontrate pune / shërbimi të vlefshme; Deshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

25. SE PARI, kërkesa për jo me pak se 4 Elektricitist, 4 Bojazhi, 4 Pllakashtrues, është një numer i lartë teresisht i pa argumentuar teknikisht.

26. Në procesverbalin "PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM", të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Prokurimit Elektronik, nuk është argumentuar në mënyrë analitike se perse duhen nga 4 punonjës dhe jo fjala vjen 5 apo pse jo 2 punonjës.

27. Sic duket qarte, argumenti se perse duhet një numer kaq ekstreme për realizimin e objektit është abuzive, pasi autoriteti thjesht referon disa nene, por pa argumentuar në bazë të një analize teknike dhe grafike numrin përkatës. Është e vertetë se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij ligjore që të vendos kriteret për jo duke mos argumentuar dot numrin

e punonjesve. Buxheti eshte i shtetit dhe autoriteti ka per detyre ligjore qe te silltet me proceduren ne menyre te kujdeshme duke shmangur kerkesa qe nuk arrin dot as ti argumentoje teknikisht.

Shoqeria jone gjykon, se kriteret per kualifikim vendosen qe ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithëkoha në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe jo te vendose kerkesa te pa argumentuara dhe qe realisht nuk i shërbejne realizimit me sukses te objektit te prokurimit. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me lpp-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së. 34. Bazuar në sa më sipër, gjykojme se referuar volumeve te punimeve ne preventive si edhe faktit se kemi te bejme me nje kantier ndertimi dhe jo disa kantier ndertimi ne disa vende te ndryshme ne distance, vlerës së kontratës, nuk eshte e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë nje staf te kualifikuar ne nje numer kaq te konsiderueshem për realizimin me sukses të kontratës. Përcaktimi i numrit të punonjësve, duhet të vijë pas një analize të hollësishme të të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra, grafiku i punimeve, afati i kontratës dhe mundësisë së mobilizimit ne punime jo vetem te stafit te kualifikuar por edhe te punonjesve te thjeshte pasi punen nuk e bejne vetem specialistet por e bejne edhe puntoret te cilet marrin udhezime nga specialistet perkates, sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi.

35. Sa më sipër, bazuar në të gjithë elementët e cituar më lartë, shoqeria jone gjykon se, kërkesa për disponimin e jo me pak se nga 4 punonjes te kualifikuar sipas specialiteteve perkatese te referuara me siper, është një kërkesë e pajustificuar nga autoriteti kontraktor. Shoqeria jone thekson se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e operatorëve ekonomikë, por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të autoriteti kontraktor, i të gjithë elementëve të cituara më sipër, me qëllim përcaktimin e numrit të punonjësve, në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, si dhe në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat për kualifikimë, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publikë, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar, parashikon se: Kerkesat e veçanta te kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në

përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në SPE, aktit mbi argumentimin e kriterëve të kualifikimit së prokurimit objekt ankimi, konstatojmë se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për disponimin e një numri kaq të madhe punonjeshish të specializuar por thjeshtë është mjaftuar me bazen ligjore që i jep të drejtë të kerkojë punonjes por ligji nuk detajon sesa duhet të vendoset numri i punonjesve pasi kjo është detyrë teknike përlllogaritjesh e autoritetit kontraktor.

36. Në këtë kuptim, shoqëria jone gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke ulur numrin e punonjësve të kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës objekt shqyrtimi. Nga sa me sipër, kërkojmë ndryshimin e kriterit duke e ulur numrin e punonjesve në 2 punonjes të specializuar ose në atë sa do të dalë nga analiza teknike e detajuar nga autoriteti kontraktor.

37. SE DYTI, kërkesa që punonjesit e specializuar duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, në një kohë që tregu Shqiptar i punës ka mangësi Specialistesh, është e tepert dhe e ekzagjeruar. Duam të sjellim në vëmendjen e autoritetit kontraktor se ka një dinamik levizjesh punonjeshish sa është gati e pa mundur garantimi se një punonjes nuk mund të ketë levizur sa në një kompani në një tjetër. Pra, kjo kërkesë nuk mund të shërbejë si një e dhënë statike e pa ndryshueshme dhe nuk i shërben autoritetit kontraktor i cili ka si qëllim final garantimin e realizimit të kontratës me sukses dhe jo të kontrollojë sa kohë ka i siguruar një specialist në një kompani ndertimi. Nuk duhet të anashkalohet fakti se autoriteti ka kërkuar realizimin e kontratave të ngjashme gjatë 5 viteve të fundit, një e dhënë kjo shumë e mirë për qëllimet e LPP-se dhe vete qëllimet e a-k për të marrë garanci se kontrata do të realizohet me sukses. Në këto kushte, kërkojmë ndryshimin e kriterit duke kërkuar që punonjesit të figurojnë të siguruar pa vënë si kufizim që ata të figurojnë në të tre muajt.

43. Shoqëria jone gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që të shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithëkoha në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. shoqëria jone sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e ligjit të prokurimit publik bazohet në këto parime: imosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të

detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

44. Shoqëria jone, gjykon se ky është një kriter i cili e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi si dhe ul konkurrencën, kriteri nuk është në proporcion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë duke mos e kufizuar atë, lidhur me periudhën e përfshirjes në listepagesat e sigurimeve shoqërore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa i përket periudhës së përfshirjes në listepagesat e sigurimeve shoqërore Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me pretendimin e ankuesit arsyeton si më poshtë: Ky kriter është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve ob saldator, bojaxhi, murator, pllakashtrues, hidroizolues, shofer pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi. Jane kërkuar punonjes të specializuar dhe të certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën. Janë kërkuar 4 elektrikiste, të cilet janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve, konkretishtjekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: Teknik ndërtimi, hidraulike, elektrikist, saldator, bojaxhi, murator, pllakashtrues, hidroizolues, shofer pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi. Jane kërkuar punonjes të specializuar dhe të certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën. Janë kërkuar 4 elektrikiste, të cilet janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve, konkretisht:

Rrjeti fuqise. Furnizimi i kuadrove

Emertimi	Njesia	Sasia
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 1x185mm, Cu (paneli kryesor)	ml	240
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 1x75mm, Cu (Gjenerator)	ml	75
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (Pompa e dozimit)	ml	55
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x10mm, Cu (Kati perdhe)	ml	5
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (Kati pare)	ml	12
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (Kati dyte)	ml	13
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x10mm, Cu (K.lab. Informatikes)	ml	35
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (K.Kaldaja)	ml	55
F.V. Kablo te TU , Un=0,6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x10mm, Cu (Palestra)	ml	32

Kuadri kryesore ne katin perdhe KK

Emertimi	Njesia	Sasia
F.V. Kuadri kryesor Kk,metalik, komp.me kit zbara 250A & aksesori J/m, me dim 850/2000/400 mm. IK08 me porte me xham .	cope	1
F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3ë, 220V	cope	2
F.V. Instrumenta mates A,V	cope	2
F.V. Automat magneto-termik, tip NSX 250, In=160A/4P kl. C ; Icc=16 KA, Un=400V	cope	1
F.V. Change over 1600A	cope	1
F.V. Automat magneto-termik, In=63 A/4P kl. C ; Icc=10 KA, Un=400V	cope	1
F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C120N, In=40A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=400V	cope	4
F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=25A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1

F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=20A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	5
F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	2
F.V. Morseta "Neuter - Toke" per kuadrin kryesor	cope	2
F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1

Kuadri kryesore ne katin perdhe KK

Emertimi	Njesia	Sasia
F.V. Kuadri plastik, komp.me kit zbara 63A & aksesor B/M, me dim 54Module	cope	1
F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	3
F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=32A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1
F.V. Automat magneto-termik diferencial, tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	20
F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1
F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=10A/1P, kl. C ; Icc=10 KA, Un=400V	cope	32
F.V. Leshues 16A, 2P	cope	1
F.V. Rele Bistabel, 220V	cope	1
F.V. Morseta "Neuter - Toke" per kuadrin e katit te dyte	cope	1
F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1

Kuadri kryesore ne katin e pare

Emertimi	Njesia	Sasia
F.V. Kuadri plastik, komp.me kit zbara 63A & aksesor B/M, me dim 54Module	cope	1
F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	3
F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=32A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1
F.V. Automat magneto-termik diferencial, tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	20
F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1
F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=10A/1P, kl. C ; Icc=10 KA, Un=400V	cope	32
F.V. Leshues 16A, 2P	cope	1
F.V. Rele Bistabel, 220V	cope	1
F.V. Morseta "Neuter - Toke" per kuadrin e katit te dyte	cope	1
F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1

Kwadri I kaldajes

Emertimi	Njesia	Sasia
F.V. Kwadri plastik, komp.me kit zbara 63A & aksesori B/M, me dim 54Module	cope	1
F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	3
F.V. Automat magneto-termik, tip C120N, In=40A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=400V	cope	1
F.V. Automat magneto-termik, tip C120N, In=32A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=400V	cope	2
F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=25A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	3
F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=20A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1
F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	3
F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	3
F.V. Leshues 16A, 2P	cope	1
F.V. Rele Bistabel, 220V	cope	1
F.V. Morseta "Neuter - Toke" per kuadrin e Boiler	cope	1
F.V. Montim kwadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1

Kwadri i Palestres

Emertimi	Njesia	Sasia
F.V. Kwadri plastik, komp.me kit zbara 40A & aksesori B/M, me dim 54Module	cope	1
F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	3
F.V. Automat magneto-termik, tip C120N, In=32A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=400V	cope	1
F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	11
F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	3
F.V. Leshues 16A, 2P	cope	1
F.V. Rele Bistabel, 220V	cope	1
F.V. Morseta "Neuter - Toke" per kuadrin e palestres	cope	1
F.V. Montim kwadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1

Sistemi i fuqise, ndricimit dhe sinjalizimit

Emertimi	Njesia	Sasia
F.V. Percjelles I veshur, flex. ;k.z. ; S=1,5 mm ²	ml	6000
F.V. Percjelles I veshur, flex. ;k.z. ; S=2,5 mm ²	ml	2500

F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ;,K.Z. FG7-OR ; S=3x4 mm ²	ml	700
F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ;,K.Z. FG7-OR ; S=3x2.5 mm ²	ml	600
F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ;,K.Z. FG7-OR ; S=3x1.5 mm ²	ml	400
F.V. Kabell monitor SVGA 20m M/FHD15 (per dalje videoprojektori)	ml	125
F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 13) dj = 16m/m	ml	2500
F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 16) dj = 20m/m	ml	100
F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 20) dj = 25m/m	ml	1100
F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 28) dj = 32m/m	ml	600
F.V. Frut çeles 1 polare , 10A	cope	80
F.V. Frut çeles devjat, & invert 10A	cope	3
F.V. Buton tasto komandimi 1P ; 16 A ; 250 V ; modulare	cope	3
F.V. Prize 1 fazore + nulifikim (bivalente) 16A	cope	90
F.V. Prize " Schucko " 16A te bardha	cope	20
F.V. Prize 2 " Schucko " 16A dy module te bardha	cope	15
F.V. Prize 2 " Schucko " 16A dy module te kuqe	cope	10
F.V. Prize TV	cope	2
F.V. Kuti per celesa e priza 3-module, suport , kapak & tapa ne mure	cope	120
F.V. Kuti per celesa e priza 4-module, suport , kapak & tapa ne mure	cope	40
F.V. Kuti shperndarese b/m. me kapak PT-2-4 dim. 150*100*50 mm	cope	42
F.V. Rele me dy gjendje Finder, In=16 A; Un=250 V	cope	3

Sistemi i fuqise, ndricimit dhe sinjalizimit

Emertimi	Njesia	Sasia
F.V. Ndriçues luminishent, FL 4x18w, IP 20	cope	160
F.V. Ndriçues luminishent, FL 2x 36w, IP 65 ambjent teknik	cope	20
F.V. Ndriçues luminishent, FL 1x60w, IP 40	cope	12
F.V. Ndriçues luminishent, FL 1x 40w, IP 65 PAR, tualet	cope	60
F.V. Ndriçues luminishent IP-40,FL 1x 8w (me mbishkrimin dalje) bat.NiCdme autonomi 2 ore	cope	10
F.V. Ndriçues emergjence, IP-40,FL 1x 8w bat.NiCdme autonomi 2 ore	cope	10
F.V. Ndriçues per pasqyre 1x35 tualeti	cope	53
F.V. Ndricues tip prozhektor IP 66 JM-TS 150w per fasaden kryesore	cope	6
F.V. Ndricues tip prozhektor 150w per palestren	cope	25
F.V. Rack 19", 42U	cope	1
F.V Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm	ml	240
F.V Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m	cope	20
F.V Percjelles bakri cu i zhveshur 1x16	ml	15

F.V. Shtize rrufeprite, tub zingato Ø=20mm, H=50cm, per mbrojtjen nga goditjet atmosferike	cope	5
--	-------------	---

Për realizimin e zerave sa më sipër, është e nevojshme dhe e domosdoshme disponimi i personelit të kualifikuar Elektracist minimumi 4 punonjes, kjo duke ju referuar volumeve dhe natyres së zërave të punimeve të parashikuar për tu realizuar. Prandaj nje kërkesë e tillë është e domosdoshme për autoritetin kontraktor.

Janë kërkuar **bojaxhi 4 punonjes**, të cilet janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të bojatisjes, sipas zërave të preventivit të punimeve, konkretisht:

PUNIME SUVATIMI, LYERJE DHE VESHJE

Emertimi	Njesia	Sasia
Lyerje brenda me Boje hidroplastike cilesi e pare	m ²	5011.8
Korimano metalike tip kangjella dekorative perfshi lyerjen	m ²	50
Hijezyes te jashtem alumini ne fasade	m ²	322

PUNIME PER PALESTREN

Emertimi	Njesia	Sasia
Vizime me boje ne fushat sportive (parket)	m ²	58
Lyerje tavane me boje hidromat vetajroses	m ²	120
Lyerje muret e brendeshme me boje plastike	m ²	726

Punime shesh dhe trotuar

Emertimi	Njesia	Sasia
Boje vaji mbi siperfaqe metalike (dy duar)	m ²	200

Për realizimin e zerave sa më sipër, është e nevojshme dhe e domosdoshme disponimi i personelit të kualifikuar Bojaxhi minimumi 4 punonjes, kjo duke ju referuar karakterit të vecantë të punimeve, volumeve dhe natyres së zërave të punimeve të parashikuar për tu realizuar. Prandaj nje kërkesë e tillë është e domosdoshme për autoritetin kontraktor. Janë kërkuar Pllakashtrues 4 punonjes, të cilet janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e veshjeve me pllake të shtresave etj., sipas zërave të preventivit të punimeve, konkretisht:

Godina e Shkollës

Emertimi	Njesia	Sasia
Prishje Pllakash ekzistuese	m ²	1701.5
Prishje shkalle ekzistuese merm. dhe shtrese me pllaka te sheshpushimet	m ³	79

PUNIME SHITRESASH PER DYSHEME

Emertimi	Njesia	Sasia
Shtrese me pllaka porcelanat	m ²	1702
plintues pllaka grez	ml	1176
Veshje me pllaka gress porc. muret EC	m ²	151.2
Shtrese me pllaka mermeri hyrja e shkollës	m ²	47
Shtrese me pllaka mermeri ne shesh pushime t=2cm	m ²	46

PUNIME PER PALESTREN

Emertimi	Njesia	Sasia
Veshje me pllaka qeramike ne nyje sanitare	m ²	50
Plintusa me pllaka gres	ml	60

Punime shesh dhe trotuar

Emertimi	Njesia	Sasia
Shttrim me pllaka guri	m ²	1200

Për realizimin e zerave sa më sipër, është e nevojshme dhe e domosdoshme disponimi i personelit të kualifikuar Pllakashtrues minimumi 4 punonjes, kjo duke ju referuar karakterit të vecantë të punimeve, volumeve dhe natyres së zërave të punimeve të parashikuar për tu realizuar. Prandaj nje kërkesë e tillë është e domosdoshme për autoritetin kontraktor. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për disponimin në stafin e tyre, e të paktën 3 (tre) Manovratorë / Eskavatoriste / Automakinist, të cilët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim kryerjen e punimeve të gërmimeve objekt kontrate, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numrit të punonjësve manovratorë, njësia e prokurimit ka patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

Për sa më sipër, ky pretendim i ankimesit nuk qëndron.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

IV) Ne kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

2.3.4 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasi</i>	<i>Statusi</i>
<i>1</i>	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 Ton</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>2</i>	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton</i>	<i>copë</i>	<i>4</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>3</i>	<i>Kamioncina me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>4</i>	<i>Eskavatore me zinxhire</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>5</i>	<i>Eskavator me goma</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

6	Fadrome me goma	copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Minieskavatore / minifadrome	copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Betonjere te vogla	copë	3	Në pronësi ose me qira
9	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qira
11	Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Rrul me vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qira
13	Vibrator betoni	copë	3	Në pronësi ose me qira
14	Skeleri	m2	3000	Në pronësi ose me qira
15	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qira
17	Elektrosaldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qira
19	Gazogjen	copë	2	Në pronësi ose me qira
20	Fabrikë betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 50 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentecioni që vërteton pronësinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; Certificate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; Certificate e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në nje foto te vetme mjete dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qira me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor; Bashkia Has.

47. SE PARI, kerketat per 1 Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20Ton, 4 Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton dhe 1 Kamioncina me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton, jane teresisht kerkesa abuzive dhe aspak te argumentuara teknikisht dhe grafikisht.

48. Autoriteti kontraktor nuk ka arritur te argumentoje teknikisht se perse duhet nje numer kaq i madh mjetesh dhe nuk ka analizuar dot ne menyre analitike se perse u dashka ky tonazh. Pra, autoriteti kontraktor nuk i eshte referuar aspak nevojave qe ka sipas zerave ne preventive perpara se te percaktonte numrin e mjeteve dhe me pas edhe tonazhin e tyre.

49. Referuar Preventivit te publikuar ne SPE nga autoriteti kontraktor, rezulton se per PUNIMET E GERMIMIT DHE MBUSHJE, eshte parashikuar zeri si ne vijim:

2 2.37/5b Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km m³ 50

13 2.37/5b Transport dheu dhe mbeturina me auto deri ne 10 km m³ 100

50. Zeri 237/5b jane ne total 150 m³ x 1.8 koeficienti ne ton sipas manualit = 270ton material per tu transportuar e distancen 10 km.

51. Referuar peshes specifike per volumin per 1 m³ ose 1.8 ton material dheu dhe material ndertimi x 10 km = 18 ton kilometer.

52. Nga 150 m³ x 18 ton kilometer = 2.700 ton x kilometer ne total.

53. Ne total kemi 2.700 ton x km cka do te thote se duke mare nje mesatare ditore transporti prej 270 ton x kilometer, rezulton se transporti mund te behet thjeshtesisht me nje kamion me kapacitet mbajtes prej 10 ton per 3 rruge ne dite per 10 dite. Pra mbyllet komplet transporti per 10 dite pune, cka do te thote se nuk duhet me shume se 1 mjet transporti me kapacitet mbajtes minimalisht 10 ton, nderkohe qe afati i kontrates eshte 12 muaj dhe kjo nuk duhet te shmanget. Madje, duam te theksojme se nje mjet e bene per 10 dite nderkohe qe afati eshte 1 vit dhe ka kohe mjaftueshem qe te realizoje transportin edhe per me shume se 10 objekte si ky i prokuruar.

54. Madje kamioni mund te kete kapacitet tonazhi edhe me te vogel per nje kohe shtrirje prej 20 ditesh te cilat kerkojne nje kamion me kapacitet mbajtes prej 5 tonesh. Cka do te thote se

serish operatori jep garanci qe punimet do te realizoh Brenda afatit madje edhe perpara afatit me kete kamion pa patur nevojte te disponoje 5 mejte transporti.

55. Sic rezulton nga analiza e mesiperme, del se kerkesa e autoritetit kontraktor per nje numer kaq te madh mjetesh kur sipas analizës nuk duhen me shume se nje mjet apo maksimumi dy mjete transporti eshte nje kerkese e pallogjikshme teknikisht. Per kete arsye, kerkojme ndryshimin e kriterit per Kamiona, duke ulur numrin e tyre ne 1 ose 2 Kamiona me kapacitet mbajtes minimalisht 10 ton ose 5 ton te cilet kane mundesi teknike te kryejne cdo punim qe ka te beje me transportin e dherave, furnizimin e materialeve apo mbetjeve nga ndertimi.

56. SE DYTI, kerkesat per 2 Eskavator me Zinxhire, 1 Eskavator me goma, 1 Fadrome me goma, 1 Minieskavator/minifadromeë jane teresisht kerkesa abusive, aspak te argumentuara teknikisht dhe grafikisht, cka sjelle kufizim te konkurrences. Pse kemi dale ne kete konkluzion3

57. Referuar Preventivit te publikuar ne SPE nga autoriteti kontraktor, rezulton se per PUNIMET E GERMIMIT DHE MBUSHJE, jane parashikuar dy zera. Konkretisht: 1 3.104/b Germim dheu per kasoneten me eskavator h=50cm m3 50 7 2.19 Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III m3 100

58. Sic duket, njeri ze eshte me Eskavator i cili nuk kufizohet nese eshte me zinxhir apo me goma dhe nga ana tjeter per vete volumin nuk ka nevojte per nje dyzine me Eskavatora por per nje Eskavator. Per kete arsye, kerkojme ndryshimin e kriterit per Eskavatora, duke ulur numrin ne nje Eskavator i cili mund te jete me zinxhir ose me goma.

59. SE TRETË, kerkesat per 3.000 M2 skela, jane teresisht kerkesa abuzive me qellim pengimin e nje pjesmarrje sa me te madhe te operatoreve ekonomik te interesuar per garen. Pse kemi dale ne kete konkluzion3

60. Referuar Projektit te publikuar ne SPE nga autoriteti kontraktor, rezulton se Gjeresia e objektit eshte (49.5 m gjatesi + 17.5 m gjeresi) = 67meter x 2 = 134 x 14 meter qe eshte lartesia e objektit pasi kemi 4 kate x 3.5 m kati duke future edhe lartesine e catise = 1,876 m2 Skela duhen per kete objekt qe mund te rrumbullakoset ne nje maksimum prej 2.000 m2 Skela por kurrsesi 3.000 M2.

61. Nga sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit per 3.000 m2 Skela sipas perlllogaritjeve te detajuara me siper.

62. SE KATERTË, kerkesa per Autobot Uji, pa vendosur si alternative edhe zgjidhje te tjera teknike alternative sic eshte disponimi i depozitave te ujit te cilat transportohen nga kamionet, apo autobote qe jane transportuar per karburant por qe jane blere nga shoqerite e ndertimit dhe perdoren per uji jo te pijshem per kantiere, eshte nje kerkese perjashtuese per shoqerite qe nuk disponojne Autobota uji por qe kane zgjidhje alternative te tjera per te sjelle uji ne kantier. Per me teper qe Autoboti i ujit ka kod te vecant pasi perdoret per uji te pijshem dhe shoqerite tona te ndertimit nuk kane pse te shpenzojne per uje te pijshem kur fare mire mund te marrin uji ne lumenj per nevojat e kantierit. Vlen te theksojme se kriteret vendosen me qellim krijimin nga autoriteti kontraktor te nje panorama sa me te qarte se operatori ekonomik do te realizoje me sukses kontraten, fakt te cilin ne e provojme me disa kontrata te realizuara me sukses, me te cilat nuk e kemi lene pa uje kantierin por e kemi furnizuar me depozita te transportuara ne kamion. Pra, mosdisponimi i nje Autoboti te ujit nuk mund te sherbeje kurrsesi si nje e dhene statike, cka do te bente qe operatori qe nuk e dispon ate, por

disponon zgjidhje teknike alternative te referuara me siper, te pa sukseshem. Vlen te theksohet se operatori qe fiton nje kontrate publike nuk mund te marre rrisht persiper qe te lere objektin e pa perfunduar se i di pasojat dhe penalitetet.

63. Per kete arsye, kerkojme qe te modifikohet kriteri duke lene si alternative jo vetem Autobot Uji por duke perfshire edhe zgjidhjet e tjera teknike te referuara me siper.

64. SE PESTI, kerkesa per 2 cop Gazogjen, eshte nje kerkese abuzive dhe aspak e argumentuar teknikisht ne Procesverbalin e Argumentimit te kriterëve kualifikuese por thjesht ka referime te disa neneve. Gjithashtu, kjo kerkese nuk eshte aspak e bazuar ne zerat e punimeve ne Preventivin e publikuar ne SPE nga autoriteti kontraktor.

65. Akoma me tej, edhe sikur autoriteti kontraktor te kishte parashikuar punime me Gazogjen ne zerat e Preventivit, serish kerkesa per 2 Cop Gazogjen eshte e pa justifikuar. Referuar zerit ne Preventivin e publikuar nga autoriteti ne SPE per konstruksionet metalike, rezulton te kete kerkuar si ne vijim:

9 2.181 F.Vkonstruksione metalike te perbera (porte e jashtme metalike+kangjella) ton 3.2

66. Totali eshte 3.2 ton konstruksione. Per 1 ton konstruksion metalik eshte parashikuar 0.7 ore pune. Pra, per 3.2 ton nevojiten 2.24 ore pune (0.7 x 3.2), cka do te thote se kerkesa per disponimin e 2 Gazogjeneve eshte e pa mbeshtetur ne nevojën hipotetike per Gazogjen, pasi 1 Gazogjen eshte mese e mjaftueshme.

67. Nga ana tjetër, edhe sikur te marrim te gjithë tubat e celikut ne teresi, serish nuk kerkohet gazogjen per keto dimesione, por duke marre ne konsiderat qe per diametrin mbi 200 mm si edhe duke pranuar se per 1 kg tub, normative eshte 0.01 ore pune, atehere per totalin 3.140 kg tuba duhen 31.4 ore pune me Gazogjen. Serish kjo nuk e justifikon kerkesen per 2 Gazogjen.

68. Persa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese si te pa argumentuar dhe te pa bazuar ne zerat e punimeve ne Preventiv.

69. SE GJASHTI, kerkesa per 1 cop Fabrike Betonië dhe qe kjo te jete ose ne Pronesi ose me Qira eshte teresisht e paligjshme. Pse u dashka qe autoriteti kontraktor me kerkesat e tij te dale mbi lejimet e Kodit Civil, kur dihet fare mire qe kompanit e ndertimit nuk kane as ne pronesi dhe as me qira Fabrika Betoni pasi kane kontrata furnizimi per Betonin dhe betonin na i sjellin me Autobetoniere ne kantier sipas porosise. Kriteri eshte ne shkelje te hapur te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe si i tille duhet te modifikohet duke shtuar si alternative edhe mundesine per disponimin e kontratave te furnizimit me Fabrika Betoni.

70. Persa me siper, kerkojme ndryshimin e kerkeses sipas argumentimit te referuar me siper.

71. SE SHTATI, kerkesa qe imjetet e deklaruar me qira te shoqerohen nga Kontrata perkatese Noteriale, eshte ne shkelje te hapur te Kodit Civil dhe vendimeve te Komisionit te Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare. Operatorët ekonomik nuk mund te ngarkohen me barre te pa nevojshme financiare pasi sic dihet per te bere nje kontrate perpara noterit duhet te paguash nje shume prej rreth 9.000 lekesh.

73. SE TETI, kerkesa qe per Pajisjet Teknike te paraqitet dokumenti me te dhenat teknike, ne nje kohe qe autoriteti nuk ka vendosur ndonje minimum apo maksimum qe duhet te permbushin teknikisht keto pajisje, e bene kerkesen teresisht abusive, evasive dhe aspak te nevojshme. Ndryshe eshte shtuar kur autoriteti ka peracaktuar keto te dhena teknike qe duhet te permbushin Pajisjet, do te kishte llogjik qe te kerkonte edhe dokumentin me keto te dhena.

74. SE NENTI, kerkesa qe per Mjetet te paraqitet FOTO, ne nje kohe qe autoriteti ka kerkuar nje dizine me dokumente si: Certifikat Pronesie, Leje Qarkullimi, Siguracion dhe Kontroll

Teknik e ben thjesht te panevoshme kete kerkese pasi dokumentet e mjetit japin informacionin e nevojshem teknik dhe ligjor.

76. Per kete arsye kerkojme heqjen e kerkeses per Foto pasi eshte nje dokument qe dublon informacionin qe jep leja e qarkullimit sic eshte eshte Targa, pesha mbajttese etje.

Në lidhje me pretendimet e Ankuesit për këtë pikë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Pikë së pari, ky kriter është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/d të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj është vendosur që të kërkohet nga operatorët ekonomik të disponojnë mjetet e pajisjet teknike sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, prandaj operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhet punimet (gërmime dheu, shtresa, konstruksione etj.) dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimet teknike objekt kontrate, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t'i realizojë këto punimeve. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave

Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, është kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate. Gjithashtu është përcaktuar dokumentecioni i nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës për disponimin e tyre, si dhe me qëllim verifikimin dhe kontrollimin se vërtet këto mjete dhe pajisje disponohen nga operatorët ekonomikë. Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga shoqëria “Kevin Konstruksion” sh.p.k. Autoriteti Kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të këtyre kërkesave, duke hartuar nje shtojcë për modifikimin e kërkesave për kualifikim. Konkretisht, makinerite dhe pajisjet që do të kërkohen për këtë procedure prokurimi, do të jenë si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 Ton	copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton	copë	2	Në pronësi ose me qira
3	Kamioncina me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	Cope	1	Në pronësi ose me qira
5	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Fadrome me goma	copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Minieskavatore / minifadrome	copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Betonjere te vogla	copë	3	Në pronësi ose me qira
9	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qira
11	Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Rrul me vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qira
13	Vibrator betoni	copë	3	Në pronësi ose me qira
14	Skeleri	m2	3000	Në pronësi ose me qira
15	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qira
17	Elektrosaldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qira
19	Gazogjen	copë	2	Në pronësi ose me qira

20	Fabrikë betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira
----	----------------	------	---	------------------------

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier", si më poshtë vijon: ➤ Kokore minimumi 50 cope ➤ Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë ➤ Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 copë ➤ Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë ➤ Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë: Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentecioni që vërteton pronesinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; Certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm). Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm). Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Për pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilen. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qira me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklararon se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Has.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

V) Ne kriteret e veçanta te kualifikimit eshte kerkuar:

77. 2.3.5 Operoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas Standardeve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht: - Certifikate ISO 9001 - 2015 "Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë", objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 14001-2015 "Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit", objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 45001-2018 "Për Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurimit në Pune", objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- *Certifikate ISO 3834-2: 2021 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësise në Saldim”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*

- *Certifikate ISO 1452-1:2009 “Për Sistemet e Tubacioneve Plastike për Furnizimin me Ujë, Kullimet dhe Kanalizimet Nentokesore dhe Mbitokesore nën Presion” ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*

- *Certifikate ISO 50001: 2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Energjise”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Nëse Certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë Certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsiper të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.*

101 Kërkesa për “Certifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, nuk është e bazuar në një argumentim shterues në procesverbalin “PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM”, të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Prokurimit Elektronik. Për më tepër që kjo kërkesë, dublon kërkesën tjetër të kualifikimit që ka të bëjë me: “2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe ertififikimet përkatëse, si më poshtë: g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / Certifikate trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë: - minimumi 1 (një) punonjës i pajisur me Certifikate ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave). - Minimumi 1 (një) punonjës me Certifikatë përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë).

78. Nga sa me sipër, del qartë, se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomik që të paraqesin dëshmi/certifikata për dy punonjës që të dy të kualifikuar për fushën e sigurisë, shëndetit dhe ndërhyrjes në raste emergjente dhe nuk ka nevojë të shtojë një kërkesë tjetër për të njëjtin qëllim. Nga sa me sipër, kërkojmë heqjen e Certifikates ISO 45001-2018 të referuar me sipër ose heqjen e kërkesave për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë dhe ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.

Në lidhje me pretendimet e Ankuesit për këtë pikë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Ky kriter është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 79, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë Standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e Standardeve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, ka kërkuar Certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Përcaktimi i bërë nga autoriteti kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar dhe certifikimin e kompanise janë kërkesa të ndryshme, të cilat gjejne rregullime të veçanta për secilen. Nuk kemi të bëjme me mbivendosje apo me kërkesa të njejta, pasi kërkesa për disponimin nga operatori ekonomik të certifikimit sipas standartit ISO 45001-2018 është e lidhur me vetë përfaqësimin e kompanise, kurse disponimi në organiken e operatorit ekonomik i personelit të kualifikuar është e ndryshme dhe lidhet me individet e punësuar.

Janë përcaktuar kriteret duke qene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Certifikate ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shendetit dhe sigurimit në pune” mundëson vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në

vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Kërkesa për “Ekspert për Ndhmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, është e lidhur me natyrën e kontratës dhe specifikat e saj, të cilat kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjes që disponon Certifikatë/dëshmi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky inxhinier i Certifikuar nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”.

Për sa më sipër, ky pretendim i ankimesit nuk qëndron.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

Ne kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar: 77. 2.3.5 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas Standardeve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht: - Certifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. - Certifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 3834-2: 2021 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në Saldim”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 1452-1:2009 “Për Sistemet e Tubacioneve Plastike për Furnizimin me Ujë, Kullimet dhe Kanalizimet Nentokesore dhe Mbitokesore në Presion” ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- *Certifikate ISO 50001: 2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Energjise”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Nëse Certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë Certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marre përsiper të realizojë, referuar kontratës së bashkepunimit të nënshkruar.*

79 *Kërkesa per Certificate ISO 3834-2: 2021 “Për Sistemin e Menaxhimit të cilësise në saldimë, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, nuk është e bazuar në një argumentim shterues në procesverbalin “PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM”, të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Prokurimit Elektronik. Per me teper qe kjo kerkese, dublon kerkesen tjeter te kualifikimit qe ka te beje me piken: 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë: e) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 30 (Tridhjetë) punonjes të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certificate trajnimi (të vlefshme), ose Deshmi Profesionale leshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:*

- *Teknik Ndertimi 1 (një)*
- *Hidraulike 3 (tre)*
- *Elektriçiste 4 (kater)*
- *Saldator 2 (dy)*
- *Bojaxhi 4 (kater)*
- *Murator 3 (tre)*
- *Pllakashtrues 4 (kater)*
- *Hidroizolues 3 (tre)*
- *Shofer 4 (kater)*

Shoferet për drejtim mjetesh duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorinë “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE” leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

80. *Nga sa me sipër, del qarte, se autoriteti kontraktor ka kerkuar nga operatorët ekonomik qe te paraqesin deshmi/certifikata per dy punonjes qe te dy te kualifikuar si Saldator. Autoriteti e krijon bindjen se saldimi do kryhet me cilesi, me kerkesen per dy saldator te certifikuar dhe cdo kerkese tjeter per te dubluar tjetren eshte teresisht e pa nevojshme dhe*

nuk i sherben aspak qellimit te hartimit te kriterëve te kualifikimit por perkundrazi krijon barrier te panevojshme. Nga sa me siper, kerkojme hejen e Certifikates ISO 3834-2: 2021 "Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në Saldimëte referuar me siper ose hejen e kerkeses per 2 Saldator te Certifikuar.

Në lidhje me pretendimet e Ankuesit për këtë pikë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Ky kriter është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 79, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, sipas të cilit: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë Standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e Standardeve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, ka kërkuar Certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Janë përcaktuar kriteret duke qene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Certifikata ISO 3834-2: 2021 "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim" është kërkuar për një cilësi sa më të mirë dhe precizion në saldimet e tubacioneve në punimet për rrjetin e tubacioneve. Duke qenë se në këtë fazë projekti kemi të bëjmë me ndertimin e objektit dhe materiali i përdorur do të jetë edhe tubo dhe kangjella sidhe materiale të tjera ku nevojitet një cilësi bashkimi, në mënyrë që të jetë sa më e qëndrueshme dhe funksionale për parashikimin e fazave të tjera, duke shmangur situatat e nevojës për riparimin e difekteve, ku si rrjedhojë do të sillte vonesa në përfundimin dhe vënien në efikasitet të investimit. Përcaktimi i bërë nga autoriteti kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar dhe certifikimin e kompanise janë kërkesa të ndryshme, të cilat gjejne rregullime të veçanta për secilen. Nuk kemi të bëjmë me mbivendosje apo me kërkesa të njejta, pasi kërkesa për disponimin nga operatori ekonomik të certifikimit sipas standartit ISO 3834-2: 2021 është e lidhur me vetë përfaqësimin e kompanise, kurse disponimi në organiken e operatorit

ekonomik i personelit të kualifikuar është e ndryshme dhe lidhet me individet e punësuar. Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: Teknik ndërtimi, hidraulike, elektrikist, saldator, bojaxhi, murator, pllakashtrues, hidroizolues, shofer pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi.

Jane kërkuar punonjes të specializuar dhe të certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Për sa më sipër pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

2.3.5 Operoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas Standardeve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht: - Certifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurimit në Pune”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 3834-2: 2021 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në Saldim”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 1452-1:2009 “Për Sistemet e Tubacioneve Plastike për Furnizimin me Ujë, Kullimet dhe Kanalizimet Nentokesore dhe Mbitokesore nën Presion” ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikate ISO 50001: 2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Energjisë”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Nëse Certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë Certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marre përsiper të realizojë, referuar kontratës së bashkepunimit të nënshkruar.

82 Kërkesa për Certifikate ISO 1452-1: 2009 “Për Sistemet e Tubacioneve Plastike për Furnizimin me Ujë, Kullimet dhe Kanalizimet Nentokesore dhe Mbitokesore nën Presion”, nuk ka lidhje me ndertuesit por me prodhuesit e tubave.

83 Referuar faqes zyrtare të Standartit Nderkombetar <https://www.iso.org/standard/50361.html>, rezulton se: ISO 1452-1:2009 specifikon aspektet e përgjithshme të sistemeve të tubacioneve me mur të ngurtë të paplastifikuar të poli(vinilklorurit) (PVC-U) të destinuara për furnizimin me ujë dhe për kullimin dhe kanalizimin nën presion dhe mbi tokë. Në lidhje me ISO 1452-2, ISO 1452-3, ISO 1452-4

dhe ISO 1452-5, është i zbatueshëm për tubat PVC-U, montimet, valvulat dhe pajisjet ndihmëse, nyjet e tyre dhe për nyjet me përbërës të plastikës dhe materiale jo plastike të destinuara për t'u përdorur për sa vijon:

- rrjetet e ujit dhe shërbimet e groposura në tokë;
- bartja e ujit mbi tokë për ndërtesat e jashtme dhe të brendshme;
- kullimi dhe kanalizimi i groposur dhe mbi tokë nën presion. Është i zbatueshëm për sistemet e tubacioneve të destinuara për furnizimin me ujë nën presion deri dhe duke përfshirë 25 C (ujë i ftohtë), i destinuar për konsum njerëzor dhe për qëllime të përgjithshme, si dhe për ujërat e zeza nën presion. Është gjithashtu i zbatueshëm për komponentët për transportimin e ujit dhe ujërave të zeza deri në dhe duke përfshirë 45 C.

84 Nga sa me sipër, del qarte se kjo ISO ka të bëjë me prodhuesin e Tubacioneve Plastike dhe kushteve që ata duhet të përmbushin për prodhimin e këtyre tubave, çka do të thote se nuk ka asnjë lidhje me kompanitë e ndërtimit të cilat nuk kanë për objekt prodhimin e tubacioneve. Nga sa me sipër, kërkojmë heqjen e Certifikates ISO 1452-1: 2009, sipas argumenteve të dhëna me sipër.

Autoriteti Kontraktor ka pranuar kërkesën e shoqërisë "Kevin Konstruktion" sh.p.k. duke vendosur për heqjen e kërkesës për disponimin e Certifikates ISO 1452-1: 2009. Ky ndryshim do të reflektohet në Dokumentet Standarde të Tenderit nëpërmjet hartimit të shtojcës për modifikimin e kërkesave për kualifikim.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

VIII) Ne Preventivin e publikuar në SPE, rezulton të ketë disa mosperputhje:

82. Se pari, Kodet e zerave të preventivit në SPE nuk janë pershtatur me kodet e manualit në fuqi por janë bazuar në manualin e vjetër, çka na bënë të dyshojmë se edhe fondi limit i publikuar nuk është i sakt.

83. Akoma me tej, kemi konstatuar se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në Preventiv për rubrikën Sistemi i Mbrojtjes Kunder Zjarrit, një sistem bashkimi Victualic, por pa specifikuar mënyra dhe zgjidhje teknike të tjera duke vendosur fjalën OSE EKUIVALNT. Nga sa me sipër, kërkojmë modifikimin e zerit të referuar me sipër duke vendosur fjalën ose ekuivalent.

84. Se dyti, zeri për kaldajën ka të specifikuar një fuqi me të lartë se fuqia e përcaktuar nga projekti. Në projekt është: $Q=349 \text{ kw}$ -, nderkohe në Preventiv është bërë - kapaciteti $Q=465 \text{ kw}$

85. Autoriteti kontraktor nuk mund të marrë kompetencën e projektuesit por duhet të qëndrojë strikt atij dhe të modifikojë fuqinë e kaldajës në preventive duke e lënë atë sipas fuqisë në projekt. Në preventive fuqia përcaktohet: - kapaciteti $Q=465 \text{ kË}$. Nga sa me sipër, kërkojmë modifikimin fuqisë në Preventiv.

Autoriteti Kontraktor ka pranuar kërkesën e shoqërisë "Kevin Konstruktion" sh.p.k. duke vendosur për modifikimin e preventivit përse i përket fuqisë së kaldajës, ashtu sic është e parashikuar në projekt. Gjithashtu do të kërkohet ose ekuivalenti për secilin rast kur është përdorur marka apo emri tregtar për materialet e kerkuara. Ky ndryshim do të reflektohet në Dokumentet Standarde të Tenderit nëpërmjet hartimit të shtojcës për modifikimin e kërkesave për kualifikim.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

IX) Në kriterete e veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar:

86. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Has.

87. Autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere të tepruara dhe që nuk i shërbejnë qëllimit final të autoritetit kontraktor për një realizim të suksesshëm të kontratës. E rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të zotërojnë të gjitha kapacitete e nevojshme teknike në rastin konkret llojin dhe numrin e mjeteve për ekzekutimin e kontratës. Cmojmë se kriteret për kualifikim i shërbejnë ak-së për të krijuar një panoramë mbi kapacitetet e oë pjesmarrës. Përcaktimi dhe kërkimi i një deklaratë ku kërkohet që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera është i pabazuar.

Nga sa me sipër analizuar, kërkojmë heqjen ose modifikimin e kërkesës që u kërkon operatoreve ekonomik që të deklarojnë se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, sipas arsytimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimeve Publike.

Në lidhje me pretendimet e Ankuesit për këtë pikë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik1 ” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesa kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/d të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivitet të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njesia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomik të disponojnë mjetet e pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala "kërkon" nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhet punimet (gërmime dheu, shtresa, vendosje tubi, konstruksione etj.) dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimet teknike objekt kontrate, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t'i realizojë këto punimeve.

Nje deklarim i tille i shërben autoritetit kontraktor pasi garanton që nëpërmjet paraqitjes së kësaj deklarate operatorët ekonomik pranojnë të deklarojnë se mjetet dhe pajisjet e kërkuara do të jenë të angazhuara në realizimin e këtij objekti, dhe jo në objekte të tjera, sidhe nuk janë të shpallura në procedura të tjera ku është shpallur fituesi pranë autoritetit kontraktor. Duke referuar në natyrën e objektit të prokurimit "Rikonstruksion i Gjinnazit Skenderbeu Krumë Has" cdo vonesë në realizimin e punimeve përtej grafikut të parashikuar të punimeve do ta bënte edhe me të vështire situaten për autoritetin kontraktor përse i përket sigurimit të ambjenteve të tjera për realizimin e mësimedhenjes për studentet që ndjekin studimet në Gjinnazin Skenderbeu, Krumë Has. Gjithashtu do detyronte autoritetin kontraktor të vazhdonte mesimin me 2 apo me 3 turne për periudha të gjata, situatë e cila do të krijonte shqetësime për studentet, stafin mesimedianes, prinderit dhe autoritetin kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se:

X) Ne kriterete e veçanta te kualifikimit autoriteti kontraktor ka kerkuar: 2.3.6 Operatori ekonomik pjesemarrës duhet të jetë i pajisur me Licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL), për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë dokumentacionin si me poshte:

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane".

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. - Licencë për Mbrojtjen nga Zjarri Kodi 1.2.A.

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.1.A , për "Magazinin dhe trajtim i mbetjeve të tjera të ujrave të zeza urbane".

89. Se pari, kerkesa qe Licenca (QKL) Kodi III.2.B Për grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane, nuk eshte e bazuar pasi autoriteti kontraktor ka kërkuar licencën e gabuar, pasi gjatë zbatimit të kontratës nuk është parashikuar grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane si e tille kerkesa duhet te hiqet.

91. Se dyti, kerkesa Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nuk eshte e bazuar dhe as e argumentuar.

92. Objekti i prokurimit ka te beje me Rikonstruksion te nje Shkolle, e cila eshte brenda nje territori te kufizuarë, dhe me 0 ndikim ne mjedis, per pasoje nuk ka asnje arsye pse te kerkohet nje license per vleresim dhe ndikim ne mjedis.

93. Per me teper qe nuk ka anje ze ne Preventiv qe te kete te beje me Vleresim dhe Ndikim ne Mjedis, per kete arsye kerkesa bie poshte si e pa bazuar dhe aspak e argumentuar.

Gjithashtu, Vleresimet e Ndikimit ne Mjedis kryhet qysh ne fazen e Projektimit dhe jo ne fazen e zbatimit zbatimit.

94. Pra, kërkesa per Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nuk eshte aspak e argumentuar dhe si e tille duhet te hiqet. Nga sa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese si te pa argumentuar.

95. Se treti, kërkesa Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.1.A për “Magazinin dhe trajtim i mbetjeve të tjera të ujrave të zeza urbane”, nuk eshte e bazuar pasi referuarlegjislacionit përkatës në fuqi, preventivit të punimeve, kjo kërkes nuk eshte në përputhje me objektin dhe volumin e kontratës që prokurohet, duke shkaktuar kufizim të panevojshëm të konkurrencës, pasi autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në preventiv, asnjë zë që lidhet me përpunimin dhe trajtimin e ujërave.

96. Akoma me tej, nuk duhet te shmanget fakti se objekti i prokurimit ka te beje me rikonstrukcionin e nje shkolle dhe jo ndertimin e rrjeteve te ujrave te bardha apo te zeza.

Në lidhje me pretendimet e Ankuesit për këtë pikë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu, shkëmbi, kanale), dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombetare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Po ashtu, referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, në zbatim nenit 25 të ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar), nenit 6 pika 1 dhe nenit 20 pika 4 të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis” (i ndryshuar), duke qënë se Operoret Ekonomik pjesëmarrës, në cilësinë e zbatuesit të punimeve duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë

të licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Kodi III.2.A) në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” Kërkesa për disponimin e licencës 1.2.A është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në të cilin përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit të zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.

Kërkesa për disponimin e licencës III.1.A , për “Magazinim dhe trajtim i mbetjeve të tjera të ujrave të zeza urbane” është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për trajtimin e ujrave të zeza urbane.

Licencat e kërkuara më lart, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme profesionale për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Për sa më sipër pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të Nenit 101 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, komisioni i shqyrtimit të ankesave i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës.

VENDOSI:

1. Të pranoj pjeserisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k. duhe hartuar nje shtojce për modifikimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit.
2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të AK”

II.8. Me shkresën nr.1248/3 prot., datë 11..06.2024 KPP ju drejtua autoriteti kontraktor me kërkesën për informacion si më poshtë:

[...] Me qëllim vijimin e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesave ju duhet të dërgoni në Komisionin e Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit duke përfshirë procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit dhe preventivin me çmime shoqëruar me analizën teknike të zërave të preventivit që mbajnë shënimin anash (Analizë/An). Gjithashtu ju duhet të dërgoni edhe përllogaritjen analitike për fuqinë punëtore dhe mjetet e kërkuar nga ana juaj mbi bazën e preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve.[...]

II. 9. Me shkresën nr. 1936 prot., datë 12.06.2024 protokolluar me tonën me nr.1248/4 prot., datë 18.06.2024 ka vënë në dispozicion të KPP-së informacionin e kërkuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesve për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me datë 24.05.2024, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike, vendimin e shqyrtimit të ankesës, i cili u protokollua me tonën me nr. 1248/2 prot., datë 27.05.2024, me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për procedurën me objekt: “Kthim - përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Gjinnazit ‘Skenderbeu’ Has”, ku konstatohet, se ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë: Konkretisht autoriteti kontraktor ka pranuar:

“[...]

Autoriteti Kontraktor ka pranuar pjesërisht kërkesën e shoqërisë “Lluca” sh.p.k. duke modifikuar kërkesat për kualifikim, konkretisht do të modifikohen kategorite NP 1 – A, NS 8-A, NS 18 – A. Ky ndryshim do të reflektohet në Dokumentet Standarde të Tenderit nëpërmjet hartimit të shtojcës për modifikimin e kërkesave për kualifikim.

.....

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të Nenit 101 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, komisioni i shqyrtimit të ankesave i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës.

VENDOSI:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Lluca” sh.p.k. duke hartuar një shtojcë për modifikimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit. 2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të AK

III.1.2 Me datë 24.05.2024, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike, vendimin e shqyrtimit të ankesës, i cili u protokollua me tonën me nr. 1249/3 prot., datë 27.05.2024, me objekt “Dërgohet vendim i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për procedurën me objekt: “Kthim përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Gjinnazit ‘Skenderbeu’ Has”, ku konstatohet, se ka pranuar pjesërisht ankesën. Konkretisht autoriteti kontraktor ka pranuar si më poshtë:

“[...]

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga shoqëria “Kevin Konstruksion” sh.p.k. Autoriteti Kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të këtyre kërkesave, duke hartuar një shtojcë për modifikimin e kërkesave për kualifikim. Konkretisht, makinerite dhe pajisjet që do të kërkohen për këtë procedure prokurimi, do të jenë si më poshtë:

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasi</i>	<i>Statusi</i>
1	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 Ton</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
2	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
3	<i>Kamioncina me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
5	<i>Eskavator me goma</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
6	<i>Fadrome me goma</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
7	<i>Minieskavatore / minifadrome</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
8	<i>Betonjere te vogla</i>	<i>copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
9	<i>Autobot uji</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
10	<i>Autobetoniere</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
11	<i>Autopompe betoni</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
12	<i>Rrul me vibrim</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
13	<i>Vibrator betoni</i>	<i>copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
14	<i>Skeleri</i>	<i>m2</i>	<i>3000</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
15	<i>Gjenerator</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
16	<i>Autovinc</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
17	<i>Elektrosaldatrice</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
18	<i>Elektroorgano</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
19	<i>Gazogjen</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
20	<i>Fabrikë betoni</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

.....

Autoriteti Kontraktor ka pranuar kërkesën e shoqërisë “Kevin Konstruksion” sh.p.k. duke vendosur për heqjen e kërkesës për disponimin e Certifikates ISO 1452-1: 2009. Ky ndryshim do të reflektohet në Dokumentet Standarde të Tenderit nëpërmjet hartimit të shtojcës për modifikimin e kërkesave për kualifikim.

.....

Autoriteti Kontraktor ka pranuar kërkesën e shoqërisë “Kevin Konstruksion” sh.p.k. duke vendosur për modifikimin e preventivit përsa i përket fuqië së kaldajes, ashtu sic është e

parashikuar në projekt. Gjithashtu do të kërkohet ose ekuivalenti për secilin rast kur është përdorur marka apo emri tregtar për materialet e kerkuara. Ky ndryshim do të reflektohet në Dokumentet Standarde të Tenderit nëpërmjet hartimit të shtojcës për modifikimin e kërkesave për kualifikim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të Nenit 101 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, komisioni i shqyrtimit të ankesave i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës.

VENDOSI:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k. duhe hartuar nje shtojce për modifikimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit.
2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të AK”

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se : Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

“2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor, për ankesat me numër ankimi elektronik A/2024/4101, datë 20.05.2024 dhe nr. 1248/2024 prot., datë 20.05.2024, si dhe A/2024/4102, datë 20.05.2024, dhe nr. 1249 prot., datë 2024, të operatorëve ekonomikë “Lluca” SHPK dhe “Kevin Konstruksion” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Lluca” SHPK dhe “Kevin Konstruksion” SHPK, ku kërkojnë modifikimin e kriterit 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, lidhur me numrin e punonjësve, ku respektivisht kërkojnë:

“Lluca” SHPK

Nisur nga sa pershkruam me siper kerkojme modifikimin e ketij kriteri dhe caktimin e nje numri punonjesish ne nume rjo me shume se 50 (pesedhjete)

“Kevin Konstruksion” SHPK

Bazuar në sa më sipër, shoqëria jone gjykon se referuar vlerës së kontratës, natyrës së punës si dhe faktit se puna nuk do kryhet ne nje kantier dhe jo ne disa kantiere ndertimi nuk del nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë nje staf kaq te madh pasi edhe ne nje kantier nuk mund te punojne nje numer kaq i madhe punonjesish, që në rastin konkretë duhet të jetë i konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës nje numer prej 30 punonjesish dhe keto ne profile te ndryshme sipas punimeve.

.....

Në këtë kuptim, kerkojme nga autoriteti kontraktor te modifikojë kriterin e mësipërm duke ulur numrin e punonjësve të kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës objekt shqyrtimi.”

III.2.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik pika 2.3.3/a është përcaktuar si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 100 (Njëqind) punonjes, duke përfshire dhe stafin teknik, për periudhen e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.2.2. Në nenin 2, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.3. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.2.4 KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.5. Në kthim - përgjigjen e autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pretendim, si dhe në informacionin që i ka dërguar KPP me shkresën nr. 1936 prot., datë 12.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1248/4 prot., datë 18.06.2024, autoriteti kontraktor është shprehur se ka pranuar pjesërisht ankesën, duke argumentuar: “[...] Nga llogaritja e oreve të punës për të gjithë zerrat e punimeve të preventivit sipas manualit të cmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si më poshtë: Total ore pune= 224,640 ore (sipas zerave të preventivit) Ore/1 dite pune= 8 ore Total Dite pune puntori= 224,640 ore/8 ore= 28,080 dite pune Dite pune gjithesej= 12 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 26 dite= 312 dite Numri i fuqisë punëtore = 28,080 dite/312 dite= 90 punëtor.

Ne mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohej për realizimin e punimeve është: 224,640 ore / 8 ore pune në dite/ 312 dite pune= 90 punëtor.”

III.2.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, duke kërkuar uljen e numrit të punonjësve pavarësisht se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, duke ulur numrin e punonjësve nga 100 në 90 punonjës, KPP gjykon, se referuar procesvebalit të hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor ka shpjeguar në mënyrë narrative dhe pa një analizë të detajuar teknike dhe profesionale, kërkesën mbi një numër kaq të lartë punonjësish, duke u mjaftuar me argumentim në mënyrë narrative, me bazë ligjore të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, por pa një analizë të detajuar se përse është një kërkesë e tillë. Gjithashtu, edhe argumentimi dhe justifikimi i autoritetit kontraktor mbi modifikimin e punonjësve në 90 të tillë nuk është i justifikuar, lidhur kjo me përmasat dhe volumin e kontratës, zërat e punimeve dhe kohëzgjatjen e tyre. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë për një numër prej 90 punonjësish është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, zërave të preventivit, si dhe kohëzgjatjes së punimeve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit, duhet të ulë numrin e punonjësve të kërkuar, pasi kërkesa e modifikuar e autoritetit kontraktor për 90 punonjës është e ekzagjeruar dhe ndikon në uljen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Sa më lart, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e lartpërmendur, duke ulur numrin e punonjësve, me qëllim krijimin e një konkurrence gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese.

Sa më sipër, pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” SHPK për pikën 2.3.3/b të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku kërkon që autoriteti kontraktor të heqë përcaktimin lidhur me disponimin nga operatorët ekonomikë të 1 (një) drejtuesi teknik të profilit strukturist, KPP vëren se,

III.3.1 Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik, pika 2.3.3/b, është përcaktuar si më poshtë:

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në Licencën e shoqërisë të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
Inxhinier Gjeodet / Topograf	1 (një)
Inxhinier Elektrik	1 (një)
Inxhinier Mjedisi	1 (një)
Inxhinier Ndërtimi Profili Struktura	1 (një)
Inxhinier Hidroteknike	1 (një)
Arkitekt	1 (një)
Inxhinier mekanik	1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

III.3.2. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës

dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.3. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.*

III.3.4 KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.3.5. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar:

“*Eshtë kërkuar të ketë në staf edhe **Inxhinier Ndërtimi, Profili Strukturist** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve. Zerat e punimeve të parashikuara për tu realizuar kërkojnë njohuri specifike të kualifikuara për realizimin e strukturave beton dhe beton arme. Për këtë arsye është e nevojshme mbikqyrja e punimeve dhe marrja e masave inxhinierike të nevojshme për mbarevajtjen e punimeve.*”

III.3.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes mbi disponueshmërinë nga operatorët ekonomikë të 1 *Inxhinier Ndërtimi, Profili Strukturist*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të dëshmojnë se disponojnë edhe 1 inxhinier ndërtimi. Referuar procesverbalit të hartimit të kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e 1 inxhinier ndërtimi profili strukturist për arsye se, “*Zerat e punimeve të parashikuara për t'u realizuar kërkojnë njohuri specifike të kualifikuara për realizimin e strukturave beton dhe beton arme. Për këtë arsye është e nevojshme mbikqyrja e punimeve dhe marrja e masave inxhinierike të nevojshme për mbarevajtjen e punimeve.*” Ndërkohë siç vihet re, ka kërkuar edhe disponimin e 1 inxhinieri ndërtimi, ku në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim e ka argumentuar vendosjen e tij ndër të tjera për arsye se: “*Është kërkuar **Inxhinier Ndërtimi, pasi projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e gërmimit, punimet e konstruksionit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, suvatimet, hidroizolimet, sistemimet e jeshtme etj.***”, çka do të thotë, që punimet e konstruksionit për të cilat është arsyeja pse autoriteti kontraktor referuar procesverbalit më sipër ka kërkuar inxhinier ndërtimi të profilit strukturist, mund të kryhen edhe nga inxhinieri i ndërtimit. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e 1 *Inxhinier Ndërtimi, Profili Strukturist* duhet të hiqet, për sa kohë gjendet e dubluar me kërkesën për disponimin e 1 *inxhinieri ndërtimi*, e përcaktuar në të njëjtin kriter. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në kushtet kur synimi i autoritetit kontraktor, për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, sa i përket personelit të nevojshëm, realizohet

nëpërmjet plotësimit të kërkesës për disponimin e 1 inxhinieri ndërtimi dhe përcaktimi i bërë për disponimin edhe të 1 inxhinieri ndërtimi të profilit strukturist nuk është më i nevojshëm për autoritetin kontraktor në funksion të realizimit të qëllimit të tij, sikurse është realizimi me sukses i kontratës, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kësaj kërkesë.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” SHPK për pikën 2.3.3/e të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku kërkon që: “- *Kërkesa për jo më pak 4 specialist, 4 bojaxhi, 4 pllakashtrues është një numër i lartë tërësisht i paargumentuar teknikisht.....kërkojmë ndryshimin e kriterit duke ulur numrin e punonjësve në 2 punonjës të specializuar ose në atë sa do të dalë nga analiza teknike e detajuar nga autoriteti kontraktor*” -*Kërkesa që punonjësit e specializuar duhet “të figurojnë të listepagesat e shoqërisë për të pakten 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave” në një kohë që tregu shqiptar i punës ka mangësi specialistesh është e tepert dhe e ekzagjeruar.....autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa i përket periudhës së përfshirjes në listepagesat e sigurimeve shoqërore”* KPP vëren se,

III.4.1 Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik pika 2.3.3/e, është përcaktuar si më poshtë:

e) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 30 (Tridhjetë) punonjes të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certificate trajnimi (të vlefshme), ose Deshmi Profesionale lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë për të pakten 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Teknik Ndertimi	1 (nje)
- Hidraulike	3 (tre)
- Elektriçiste	4 (kater)
- Saldator	2 (dy)
- Bojaxhi	4 (kater)
- Murator	3 (tre)
- Pllakashtrues	4 (kater)
- Hidroizolues	3 (tre)
- Shofer	4 (kater)

Shoferet për drejtim mjetesesh duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorine “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE” lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së*

afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

III.4.2. Në nenin 2, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.3. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.4.4 KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.4.5. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor, vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar: “

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson, se operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: **Teknik ndërtimi, hidraulike, elektrikist, saldator, bojaxhi, murator, pllakashtrues, hidroizolues, shofer pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt - kontrate prokurimi.**

Jane kërkuar punonjes të specializuar dhe të certifikuar me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e**

aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

.....

*Janë kërkuar **elektriciste**, të cilet janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.*

.....

*Janë kërkuar **bojaxhi**, të cilet janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të bojatisjes, sipas zërave të preventivit të punimeve.*

.....

*Janë kërkuar **pllakashtrues**, të cilet janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e veshjeve me pllake të shtresave etj., sipas zërave të preventivit të punimeve.*

.....”

III.4.6. Në lidhje me kundërshtimet e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” SHPK, mbi modifikimin e kërkesës për 4 elektricistë, 4 bojaxhi, 4 pllakashtrues, KPP gjykon, se referuar procesvebalit të hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor ka shpjeguar në mënyrë narrative dhe pa një analizë të detajuar teknike dhe profesionale, kërkesën mbi numrin e kërkuar të tyre, duke u mjaftuar me vendosjen e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, i cili justifikon vendosjen e kriterëve nga pikëpamja ligjore, por nuk përcakton numër konkret, i cili duhet të vijë si rezultat i një analizë të detajuar teknike, për vendosjen e një kërkesë e tillë. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë për një numër prej 4 punonjësish të profilit elektricis, bojaxhi, pllakashtrues, është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet, në zbatim të nenit 77, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, zërave të preventivit, si dhe kohëzgjatjes së punimeve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit, duhet të ulë numrin e kërkuar për 4 elektricistë, 4 bojaxhi, 4 pllakashtrues, pasi është e ekzagjeruar dhe ndikon në uljen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë ose të përcaktojë numrin në aq sa do të dalë nga analiza teknike e detajuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshtatimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshtatur sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Sa më lart, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të ulë numrin e kërkuar për 4 elektricistë, 4 bojaxhi, 4 pllakashtrues, pasi është i ekzagjeruar dhe ndikon në uljen e

konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë ose të përcaktojë numrin në aq sa do të dalë nga analiza teknike e detajuar nga autoriteti kontraktor.

Lidhur me kundërshtimet e ankimuesit “*Kërkesa që punonjësit e specializuar duhet “të figurojnë të listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave” në një kohë që tregu shqiptar i punës ka mangësi specialistesh është e tepert dhe e ekzagjeruar.....autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa i përket periudhës së përfshirjes në listepagesat e sigurimeve shoqërore”* Komisioni gjykon se referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. KPP, gjykon, se kjo është një kërkesë e cila e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi, si dhe ul konkurrencën dhe jo në proporcion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke mos e kufizuar atë, lidhur me periudhën e përfshirjes në listepagesat e sigurimeve shoqërore. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin, sa i përket periudhës së përfshirjes në listepagesat e sigurimeve shoqërore.

Sa më lart, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” SHPK për pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku kërkon që: “- *SE PARI, kërkesat për “1 Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 Ton, 4 Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton dhe 1 Kamioncina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton”, janë teresisht kërkesa abuzive dhe aspak të argumentuara teknikisht dhe grafikisht..... Per kete arsye, kërkojme ndryshimin e kriterit per Kamiona, duke ulur numrin e tyre ne 1 ose 2 Kamiona me kapacitet mbajtës minimalisht 10 ton ose 5 ton te cilet kane mundesi teknike te kryejne cdo punim qe ka te beje me transportin e dherave, furnizimin e materialeve apo mbetjeve nga ndertimi.”*

- *SE DYTI, kërkesat për “2 Eskavator me Zinxhire, 1 Eskavator me goma, 1 Fadrome me goma, 1 Minieskavator/minifadrome” janë teresisht kërkesa abuzive, aspak të argumentuara teknikisht dhe grafikisht, cka sjelle kufizim të konkurrencës. Pse kemi dale ne kete konkluzion?..... Per kete arsye, kërkojme ndryshimin e kriterit per Eskavatora, duke ulur numrin ne nje Eskavator i cili mund te jete me zinxhir ose me goma.*

- *SE TRETI, kërkesat për 3.000 M2 skela, janë teresisht kërkesa abuzive me qëllim pengimin e një pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve ekonomikë të interesuar për garën. Pse kemi dale ne kete konkluzion?.... Nga sa me siper, kërkojme ndryshimin e kriterit per 3.000 m2 Skela sipas perlllogaritjeve te detajuara me siper.”*

- *SE KATERTI, kërkesa për Autobot Uji, pa vendosur si alternative edhe zgjidhje të tjera teknike alternative sic eshte disponimi i depozitave te ujit te cilat transportohen nga kamionet, apo autobote qe jane transportuar per karburant por qe jane blere nga shoqerite e*

ndertimit dhe perdoren per uji jo te pijshem per kantiere, eshte nje kerkese perjashtuese per shoqerite qe nuk disponojne Autobota uji por qe kane zgjidhje alternative te tjera per te sjelle uji ne kantier..... Per kete arsye, kerkojme qe te modifikohet kriteri duke lene si alternative jo vetem Autobot Uji por duke perfshire edhe zgjidhjet e tjera teknike te referuara me siper.”

- SE PESTI, kerkesa per “2 cop Gazogjen”, eshte nje kerkese abuzive dhe aspak e argumentuar teknikisht ne Procesverbalin e Argumentimit te kriterave kualifikuese por thjesht ka referime te disa neneve. Gjithashtu, kjo kerkese nuk eshte aspak e bazuar ne zerat e punimeve ne Preventivin e publikuar ne SPE nga autoriteti kontraktor.

- SE GJASHTI, kerkesa per “1 cop Fabrike Betoni” dhe qe kjo te jete ose ne Pronesi ose me Qira eshte teresisht e paligjshme. Pse u dashka qe autoriteti kontraktor me kerkesat e tij te dale mbi lejimet e Kodit Civil, kur dihet fare mire qe kompanit e ndertimit nuk kane as ne pronesi dhe as me qira Fabrika Betoni pasi kane kontrata furnizimi per Betonin dhe betonin na I sjellin me Autobetoniere ne kantier sipas porosise..... dueht të odifikohet duke shtuar si alternative edhe mundësinë për disponimin e kontratave të furnizimit me fabrika betoni. Persa me siper, kerkojme ndryshimin e kerkeses sipas argumentimit te referuar me siper.”

- SE SHTATI, kerkesa qe “mjetet e deklaruar me qira te shoqerohen nga Kontrata perkatese Noteriale”, eshte ne shkeje te hapur te Kodit Civil dhe vendimeve te Komisionit te Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare.

-SE TETI, kerkesa qe per Pajisjet Teknike te paraqitet dokumenti me te dhenat teknike, ne nje kohe qe autoriteti nuk ka vendosur ndonje minimum apo maksimum qe duhet te permbushin teknikisht keto pajisje, e bene kerkesen teresisht abusive, evasive dhe aspak te nevojshme.

-SE NENTI, kerkesa qe per Mjetet te paraqitet FOTO, ne nje kohe qe autoriteti ka kerkuar nje dyzine me dokumente si: Certifikat Pronesie, Leje Qarkullimi, Siguracion dhe Kontroll Teknik e ben thjesht te panevoshme kete kerkese pasi dokumentet e mjetit japin informacionin e nevojshem teknik dhe ligjor. Per kete arsye kerkojme heqjen e kerkeses per Foto pasi eshte nje dokument qe dublon informacionin qe jep leja e qarkullimit sic eshte eshte Targa, pesha mbajtese etje etj.” KPP vëren se,

III.5.1 Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik pika 2.3.4, është përcaktuar si më poshtë:

2.3.4 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarres duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 Ton	copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton	copë	4	Në pronësi ose me qira

3	<i>Kamioncina me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
4	<i>Eskavatore me zinxhire</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
5	<i>Eskavator me goma</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
6	<i>Fadrome me goma</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
7	<i>Minieskavatore / minifadrome</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
8	<i>Betonjere te vogla</i>	<i>copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
9	<i>Autobot uji</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
10	<i>Autobetoniere</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
11	<i>Autopompe betoni</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
12	<i>Rrul me vibrim</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
13	<i>Vibrator betoni</i>	<i>copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
14	<i>Skeleri</i>	<i>m2</i>	<i>3000</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
15	<i>Gjenerator</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
16	<i>Autovinc</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
17	<i>Elektrosaldatrice</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
18	<i>Elektroorgano</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
19	<i>Gazogjen</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
20	<i>Fabrikë betoni</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 50 cope*
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentecioni që vërteton pronesine e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; Certificate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; Certificate e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në nje foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Has.

III.5.2. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës

dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.5.3. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.*

III.5.4 KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.5.5. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, autoriteti kontraktor, vendosjen e një kriteri të tillë e ka argumentuar: "**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹"** në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."

Në **nenin 39 "Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike" pika 6/d të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik"** (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: "**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...** d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Këto mjete dhe pajisje referuar preventiv të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njesia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomik të disponojnë mjetet e pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala "**kërkon**" nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhet punimet (gërmime dheu, shtresa, shtrim asfalti, vendosje tubi, konstruksione etj.) dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimet teknike**

objekt kontrate, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t'i realizojë këto punimeve. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt - kontrate. Gjithashtu njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës për disponimin e tyre, si dhe me qëllim verifikimin dhe kontrollimin se vërtet këto mjete dhe pajisje disponohen nga operatorët ekonomikë.”

III.5.6. Në lidhje me kundërshtimet e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” SHPK, mbi modifikimin e kërkesës për kamionë, duke ulur numrin e tyre në 1 ose 2 kamionë me kapacitet mbajtës minimalisht 10 ton ose 5 ton, KPP gjykon, se referuar procesvebalit të hartimit të kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor ka shpjeguar në mënyrë narrative dhe pa një analizë të detajuar teknike dhe profesionale kërkesën mbi numrin e kërkuar të tyre, duke u mjaftuar me argumentim në mënyrë narrative me bazë ligjore të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, i cili justifikon vendosjen e tyre nga pikëpamja ligjore, por nuk përcakton numër konkret dhe tonazhin e mjeteve, i cili duhet të vijë si rezultat i një analizë të detajuar teknike, se përse është vendosur një kërkesë e tillë. Gjithashtu edhe përmes shkresës me numër 1936 prot., datë 12.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1248/4 prot., datë 12.06.2024, ka shpjeguar në mënyrë narrative pa argumente teknike një kërkesë të tillë. Nga ana tjetër, operatori ekonomik ankimues ka arritur të argumentojë në mënyrë të detajuar nga pikëpamja teknike, se përse duhet modifikuar kjo kërkesë lidhur me numrin dhe tonazhin e kamionëve sipas pretendimeve të tij. Prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e një kërkesë të tillë sipas pretendimeve të ankimuesit.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit për numrin e eskavatorëve, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës, ka pranuar pjesërisht pretendimet e autoritetit kontraktor, duke hequr kërkesën për 2 eskavatorë me zinxhirë dhe duke lënë vetëm 1 eskavator me goma, për të cilin KPP më sipër në këtë vendim ka vendosur dhe mbylljen e çështjes, ndërsa referuar kërkesës së autoritetit kontraktor edhe për 1 fadromë me goma dhe 1 minieskavator, KPP e gjen të ekzagjeruar dhe jo në proporcion me volumin dhe kohëzgjatjen e kontratës, si dhe me zërat e punimeve, prandaj autoriteti kontraktor në funksion të rritjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit dhe eliminimit të pengesave në radhët e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, duhet të marrë masa për heqjen e kërkesave për 1 fadromë me goma dhe 1 mineskavator/minifadromë, pasi referuar zërave edhe volumit të punimeve, ato mund të përmbushen edhe nga 1 eskavator me goma siç autoriteti kontraktor ka vendosur.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit për ndryshimin e kriterit për skela sipas përlllogaritjeve të detajuara që ankimuesi ka kryer, KPP duke u referuar në pretendimet e ankimuesit, si dhe në procesverbalin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, vëren se autoriteti kontraktor ka shpjeguar në mënyrë narrative dhe pa një analizë të detajuar teknike dhe profesionale, kërkesën për aq metra katror skeleri. Ndërsa operatori ekonomik në parashtrimet e tij në ankesë ka përlllogaritur dhe argumentuar, se përse duhet më pak metra

katrorë skeleri nga ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kësaj kërkesë.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit, se kërkesa për disponimin e 1 autoboti uji në pronësi apo me qira, pa marrë parasysh edhe alternativa të tjera përmes të cilave mund të sigurohet kryerja e shërbimit për realizimin e punimeve, KPP gjykon se vërtetë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë në kompetencën e autoritetit kontraktor por ato nuk duhet të jenë diskriminuese dhe kufizuese të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kuadër, përcaktimi nga autoriteti kontraktor i një autoboti uji, në pronësi apo me qira, pa përcaktuar mënyra të tjera përmes të cilave mund të sigurohet ky shërbim (sigurimi i ujit) për realizimin e ndërtimit, është kufizues dhe përjashtues në radhët e operatorëve ekonomikë, pasi sigurimi i ujit mund të arrihet jo vetëm duke pasur autobot uji në pronësi apo me qira, por edhe në mënyra të tjera alternative, pasi për autoritetin kontraktor në këtë rast, i rëndësishëm është realizimi i ndërtimit dhe përmbushja me sukses e kontratës. Duke e parë në këtë këndvështrim, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ndryshimin e kërkesës më sipër, duke parashikuar dhe mënyra të tjera alternative për sigurimin e ujit, jo vetëm përmes disponimit të autobotit të ujit.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit, se kërkesa për “2 copë Gazogjen” është një kërkesë abuzive dhe aspak e argumentuar teknikisht dhe kërkon heqjen e kësaj kërkesë si të paargumentuar dhe të pabazuar në zërat e preventivit, KPP vëren, se referuar pretendimeve të ankimuesit dhe pas analizimit të zërave të preventivit, rezulton, se në këtë të fundit është përcaktuar zëri: *2.181 F.V konstruksione metalike të perbera (portë e jashtme metalike+kangjella)*, për realizimin e të cilit KPP gjykon, se disponimi nga operatorët ekonomikë i 1 gazogjeni është i nevojshëm. Në kuadër KPP gjykon, se referuar zërit më sipër të preventivit, disponimi i gazogjenit është i nevojshëm, por autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për rishikimin e numrit të kërkuar, duke e ulur atë, pasi kërkesa për 2 copë gazogjen është e ekzagjeruar dhe nuk është në përputhje me zërat e preventivit.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit, se kërkesa për disponimin e 1 fabrike betoni në pronësi apo me qira pa marrë parasysh edhe alternativën për disponimin e kontratave të furnizimit me fabrika betoni përmes të cilave mund të sigurohet malli (betoni) për realizimin e punimeve, KPP gjykon, se vërtetë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë në kompetencën e autoritetit kontraktor, por ato nuk duhet të jenë diskriminuese dhe kufizuese të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kuadër, përcaktimi nga autoriteti kontraktor, 1 fabrike betoni në pronësi apo me qira, pa përcaktuar edhe alternativën për disponimin e kontratave të furnizimit me fabrika betoni, është haptazi kufizues dhe përjashtues në radhët e operatorëve ekonomikë për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit, pasi sigurimi i betonit mund të arrihet veçanërisht përmes kontratave të furnizimit të operatorëve ekonomikë me fabrikat e betonit, pasi për autoritetin kontraktor në këtë rast, i rëndësishëm është realizimi i ndërtimit dhe përmbushja me sukses e kontratës. Duke e parë në këtë këndvështrim, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ndryshimin e kërkesës më sipër, duke parashikuar dhe mënyrë tjetër alternative për sigurimin e betonit përmes kontratave të furnizimit të operatorëve ekonomikë me fabrika betoni.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit, mbi kërkesën që: *“mjetet e deklaruara me qira të shoqërohen nga kontrata përkatëse noteriale është në kundërshtim të hapur të Kodit Civil dhe vendimeve të KPP-së”*, Komisioni i Prokurimit Publik i referohet dispozitave të Kodit Civil, përkatësisht nenit 801, në të cilin përcaktohet, se *“Qiraja është kontrata me të cilën*

njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar” dhe në nenin 803 të Kodit Civil është cituar, se “Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë”. Pra përcaktohet qartë, se kontratat e qirasë për pasuritë e paluajtshme, bëhen me akt noterial, ndërsa kontratat e qirasë për pasuri të luajtshme, nuk është detyrim të bëhen me akt noterial. Komisioni i Prokurimit Publik e gjen të tepërt kërkesën e Autoritetit Kontraktor, që mjetet e deklaruara me qira të shoqërohen nga kontrata përkatëse noteriale, duke e ngarkuar me barrë të panevojshme operatorin ekonomik, për të lidhur kontratë qiraje me akt - noterial. Për autoritetin kontraktor është i rëndësishëm disponimi nga operatori ekonomik, i një mjeti transporti të kërkuar, ku provueshmëria lidhur me këtë kapacitet, mund të bëhet edhe me një kontratë qiraje të lidhur mes palëve, konform dispozitave të parashikuara në legjislacionin përkatës, duke ofruar garanci dhe siguri për autoritetin kontraktor, për realizimin me sukses të kontratës. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, që autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesën më sipër, në heqjen e termit “noteriale” në kontratën e qirasë për mjete transporti, me qëllim për të lehtësuar operatorët ekonomikë, për pjesëmarrje në procedurën e tenderimit, në kushtet kur forma noteriale e kërkuar, nuk është e detyrueshme referuar parashikimeve ligjore në fuqi.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi kërkesën, që për pajisjet teknike të paraqitet dokumenti me të dhënat teknike, në një kohë që autoriteti kontraktor nuk ka vendosur ndonjë minimum apo maksimum që duhet të përmbushin teknikisht këto pajisje, KPP vëren, se referuar dosjeve të specifikimeve teknike të ngarkuara në SPE si pjesë integrale e dokumenteve të tenderit dhe gjithë dokumentacionit tjetër shoqërues të dokumenteve standarde të tenderit, nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë përcaktuar qoftë edhe një minimum specifikimesh teknike që duhen plotësuar për mjetet teknike, me qëllim që përmes kërkesës për dokumente teknike që autoriteti ka kërkuar, të verifikohet përputhja e përmbajtjes së tyre me specifikimet teknike në dokumentet e tenderit. Akoma më tej, KPP vëren, se edhe autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argumentim në kthimin e përgjigjes në lidhje me këtë pretendim dhe në këtë kuadër KPP gjykon, se për sa kohë që nuk ka qoftë edhe një minimum specifikimesh teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, kërkesa që të paraqitet dokumenti me të dhëna teknike, është e pajustificuar, pasi qëllimi i këtij dokumenti është verifikimi i përputhshmërisë së përmbajtjes së të dhënave të tij me specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuadër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kërkesës për paraqitjen e dokumentit me të dhënat teknike për pajisjet teknike.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi kërkesën që për mjetet të paraqiten foto, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e fotove të mjeteve, përveç aktit të pronësisë, lejes së qarkullimit, certifikates së kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionit të mjetit (i vlefshëm), është një kërkesë e tepërt dhe shkon përtej asaj çfarë është e nevojshme të provohet nëpërmjet saj. Komisioni gjykon, se ajo çka autoriteti kontraktor kërkon të vërtetojë nëpërmjet paraqitjes së fotove (targën e mjetit, peshën mbajtëse të tij, etj) ashtu sikurse edhe operatori ekonomik me të drejtë ngre pretendimin, realizohet nëpërmjet lejes së qarkullimit. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentet e tenderit për heqjen e kriterit të paraqitjes së fotove të mjetit.

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë plotësisht, përjashtuar pretendimin për “2 copë gazogjen”, i cili qëndron pjesërisht.

III.7. Lidhur me pretendimin e ankimesit për heqjen e certifikatës ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.”, përcaktuar në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim, ose heqjen e kërkesave për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, KPP vëren se,

III.7.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik pika 2.3.3/g është përcaktuar si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt - kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

.....

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) punonjes i pajisur me Certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").
- Minimumi 1 (një) punonjës me Certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

Ndërsa po në këtë shtojcë në pikën 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.5 autoriteti kontraktor ka përcaktuar: *“2.3.5 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas Standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:*

- *Certifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*

- *Certifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurimit në Pune”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 3834-2: 2021 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësise në Saldim”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 1452-1:2009 “Për Sistemet e Tubacioneve Plastike për Furnizimin me Uje, Kullimet dhe Kanalizimet Nentokesore dhe Mbitokesore në Presion” ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 50001: 2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Energjise”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*

Nëse Certifikatat janë në gjuhe të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë Certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marre përsiper të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.”

III.7.2. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.7.3. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.*

III.7.4. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.7.5. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor është argumentuar:

“Argumentimi: Kërkesa për “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, është e lidhur me natyrën e kontratës dhe specifikat e saj, të cilat kërkojnë

njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjes që disponon Certifikatë/dëshmi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky inxhinier i Certifikuar nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”.

.....

Certifikate ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” mundëson vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.”

III.7.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes mbi disponueshmërinë nga operatorët ekonomikë të ***Certifikate ISO 45001-2018***, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë edhe ***Certifikate ISO 45001-2018*** “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”. Referuar procesverbalit të hartimit të kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e një kërkesë të tillë, duke e lidhur me: “mundëson vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u

eksponohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës, duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt - prokurimi.”. Siç vihet re, autoriteti kontraktor e lidh sigurimin e ISO më sipër, me vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik, në lidhje me vlerësimin e rrezikut në punë, me qëllimin final, reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës, ndërsa argumentimi mbi disponimin e 1 Eksperti për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave” dhe 1 “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, e lidh me njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta, për të zgjidhur çështje që lidhen profilet e tyre. Siç vihet re nga argumentimi i autoritetit kontraktor, por edhe në gjykimin e tij, KPP vlerëson, se nuk ndodhemi përballë dublimit të kërkesave të autoritetit kontraktor në këtë rast, sepse certifikimi ISO lidhet me operatorin ekonomik me statusin e personit juridik apo fizik, ndërsa profilet më sipër dhe certifikimet përkatëse, lidhen me cilësitë profesionale të punonjësve në bazë të një marrëdhënie kontraktuale që kanë me operatorin ekonomik. Sa më lart, KPP i gjen të drejta kërkesat e autoritetit kontraktor dhe pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.8. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për heqjen e certifikatës ISO 3834-2: 2021 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në Saldim”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim, ose heqjen e kërkesave për “dy saldator të certifikuar”, KPP referuar të njejtimit arsyetim si më sipër, gjykon, se pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë, pasi nuk ndodhemi përballë dublimit të kërkesave të autoritetit kontraktor në këtë rast, sepse certifikimi ISO lidhet me operatorin ekonomik me statusin e personit juridik apo fizik, ndërsa profili saldator dhe certifikimet përkatëse, lidhen me cilësitë profesionale të punonjësve në bazë të një marrëdhënie kontraktuale që kanë me operatorin e ekonomik. Sa më lart, KPP e gjen të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor dhe pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.9. Lidhur me pretendimin e ankimuesit, i cili kërkon heqjen e kërkesës që operatorët ekonomikë të deklarojnë se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, KPP vëren se,

III.9.1. Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik pika 2.3.4 është përcaktuar si më poshtë:

2.3.4 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarres duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasi</i>	<i>Statusi</i>
<i>1</i>	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

	20 Ton			
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton	copë	4	Në pronësi ose me qira
3	Kamioncina me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	Cope	1	Në pronësi ose me qira
4	Eskavatore me zinxhire	copë	2	Në pronësi ose me qira
5	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Fadrome me goma	copë	1	Në pronësi ose me qira
7	Minieskavatore / minifadrome	copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Betonjere te vogla	copë	3	Në pronësi ose me qira
9	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qira
11	Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Rrul me vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qira
13	Vibrator betoni	copë	3	Në pronësi ose me qira
14	Skeleri	m2	3000	Në pronësi ose me qira
15	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qira
17	Elektrosaldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qira
19	Gazogjen	copë	2	Në pronësi ose me qira
20	Fabrikë betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 50 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentecioni që vërteton pronesine e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; Certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në nje foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Has.

III.9.3. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të

ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.9.4. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.*

III.9.5. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.9.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi heqjen e deklaratës që mjetet dhe pajisjet nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera, që për mjetet dhe pajisjet, të bëhet dhe deklarata më sipër. Ashtu siç është theksuar më sipër, KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor për deklarimin, se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që kontenierët dhe mjetet, të jenë në dispozicion për zbatimin e kontratës, pas lidhjes së kësaj të fundit dhe jo në fazën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për këtë arsye, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron, e për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Kevin Konstruksion" SHPK për pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku kërkon që: *"Se pari, kërkesa që Licenca (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane", nuk është e bazuar pasi autoriteti kontraktor ka kërkuar licencën e gabuar, pasi gjatë zbatimit të kontratës nuk është parashikuar grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane si e tille kërkesa duhet te hiqet.."*

- *Se dyti, kërkesa "Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", nuk është e bazuar dhe as e argumentuar..... Pra, kërkesa për "Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" nuk është aspak e argumentuar dhe si e tille duhet te hiqet."*

- *Se treti, kërkesa Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.1.A për "Magazinim dhe trajtim i mbetjeve të tjera të ujrave të zeza urbane, nuk është e bazuar pasi referuar legjislacionit përkatës në fuqi, preventivit të punimeve, kjo kërkesë nuk është në*

përputhje me objektin dhe volumin e kontratës që prokurohet, duke shkaktuar kufizim të panevojshëm të konkurrencës, pasi autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në preventiv, asnjë zë që lidhet me përpunimin dhe trajtimin e ujërave.” KPP vëren se,

III.10.1 Në dokumentet standarde të tenderit, shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3. kapaciteti teknik, pika 2.3.6, është përcaktuar si më poshtë:

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL), për zbatimin e punimeve objekt - kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë dokumentacionin si me poshte:

- *Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane”.*
- *Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.*
- *Licencë për Mbrojtjen nga Zjarri Kodi 1.2.A.*
- *Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.1.A , për “Magazinin dhe trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”.*

III.10.2. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.10.3. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.*

III.10.4. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.10.5. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor vendosjen e një kriteri të tillë, e ka argumentuar:

“Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore

përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu, shkëmbi, kanale), dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Po ashtu, referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, në zbatim nenit 25 të ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar), nenit 6 pika 1 dhe nenit 20 pika 4 të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis” (i ndryshuar), duke qënë se Operoret Ekonomik pjesëmarrës, në cilësinë e zbatuesit të punimeve duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Kodi III.2.A) në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”

Kërkesa për disponimin e licencës 1.2.A është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në të cilin përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit të zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.

Kërkesa për disponimin e licencës III.1.A , për “Magazinim dhe trajtim i mbetjeve të tjera të ujrave të zeza urbane” është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për trajtimin e ujrave të zeza urbane.

Licencat e kërkuara më lart, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme profesionale për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.”

III.10.6. Në nenin 25 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, parashikohet:

“1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

2. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

5. Kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.”

III.10.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.11. Lidhur me pretendimet e ankimesit mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e Licencës të lëshuar nga QKL për grumbullimin, transportim, ruajtje, e mbetjeve Urbane (kodi III.2.B), Komisioni gjykon se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të

provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik, e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 *“Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*, parashikohet se *“Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”*

Sa më sipër, KPP gjykon se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, nuk shfaqet kryerja e veprimtarisë së grumbullimit dhe transportimit të mbejeteve urbane. Autoriteti kontraktor ka kërkuar licencën e gabuar në dokumentet e tenderit, pasi gjatë zbatimit të kontratës nuk është parashikuar grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, në kuptim të ligjit nr.8094 datë 21.3.1996 *“Për largimin publik të mbeturinave”*. Komisioni thekson, se kërkesa joproporcionale, mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë të operatorëve ekonomikë në fazën e vlerësimit të ofertave. Ndaj në këtë kuptim, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kërkesës, për paraqitjen e Licencës me Kodin III.2.B, pasi nuk është në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi kërkesën e autoritetit kontraktor, për disponimin e licencës së lëshuar nga QKL, me kod III.2.A *“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”*, KPP gjykon, se referuar preventivit të punimeve, jo vetëm që nuk ka zëra në preventiv që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe ndikimin në mjedis, por gjithashtu, referuar nenin 25 pika 4 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, *“Për mbrojtjen e mjedisit”*, parashikohet: *4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.”*, çfarë do të thotë, që vlerësimet e ndikimit në mjedis, kryhen nga zhvilluesi, që në fazat e hershme të përgatitjes për planifikimin e një projekti dhe jo në fazën e zbatimit të tij. Prandaj kërkesa e autoritetit kontraktor për licencën me kod III.2.A *“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”* është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit dhe duhet të marrë masa për heqjen e saj.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi kërkesën e autoritetit kontraktor, për disponimin e licencës së lëshuar nga QKL me kod III.1.A për *“Magazinim dhe trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”*, referuar legjislacionit përkatës në fuqi, preventivit të punimeve, Komisioni gjykon, se kërkesa nuk është në përputhje me objektin dhe volumin e kontratës që prokurohet, duke shkaktuar kufizim të panevojshëm të konkurrencës, pasi autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në preventiv, asnjë zë që lidhet me përpunimin dhe trajtimin e ujërave të zeza urbane. Në këto kushte, me qëllim hapjen e konkurrencës dhe mosdiskriminimin në mënyrë të panevojshme të operatorëve ekonomikë të interesuar, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të heqë kërkesën e mësipërme për disponimin e licencës së lëshuar nga QKL me kod III.1.A për *“Magazinim dhe trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”*, pasi nuk është në përputhje me objektin e prokurimit dhe volumet e kontratës.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.12. Lidhur me pretendimin e ankimesit se: “Kodet e zërave të preventivit në SPE nuk janë përshtatur me kodet e manualit në fuqi, por janë bazuar në manualin e vjetër, çka na bën të dyshojmë se fondi limit nuk është saktë.” KPP vëren se,

III.12.1. Në preventivin pa çmime të publikuar në SPE, i cili është pjesë integrale e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

PREVENTIV I PUNIMEVE

Objekti: "Rikonstruksion I Gjimnazit "SKENDERBEU", Bashkia Has"
Investitori: Bashkia Has

Nr	Nr.An	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
Godina e Shkolles						
PUNIME PRISHJE						
1	An-N. 1	Prishje e sivatimit ekzistues ne mure dhe tavane(jashu dhe brenda)	m ²	6110.7		
2	An-N. 2	Prishje Plakash ekzistuese	m ²	1701.3		
3	An-N. 3	Cmonim dher ekzistuese	m ²	103		
4	An-N. 4	Cmonim dritare ekzistuese	m ²	235		
5	An-N. 5	Heqje e linjave te vjetra ekzistuese elektrike eej	ml	1050		
6	An-N. 6	Cmonim lloqje pajisje te vjetra ekzistuese (wc, lavaman, pishuar eej)	cupe	15		
7	An-N. 7	Cmonim catie ekzistuese	m ²	758		
8	An-N. 8	Prishje shkalle ekzistuese merm. dhe shtrese me pllaka te sheshpshimes	m ²	79		
9	2.426/1	Prishje mur tulle objekti i vjeter	m ²	12		
10	2.426/6	Prishje struktura betoni B/A	m ²	5		
11	An-N. 9	Heqje rrucesave te vjetra ekzistues	cupe	87		
12	An-N. 10	Heqje e pajisjeve te vjetra te kondicionimit, mbyllja e tubacioneve hidraulike dhe tapoja e tyre	cupe	15		
13	2.37.5b	Transporti dheu dhe mbeturina me auto deri ne 10 km	m ³	100		
SHUMA I						
PUNIME KONSTRUKSIONI DHE CATIE/MBULESE						
1	2.218	Cati vendi zakonshtme 11D-8m, mbluar me llogjalla vendi	m ²	820		
2	2.209/b	Ulluk shkarkimi vertikal me baker	ml	45		
3	2.212/b	Ulluk shkarkimi horizontal me baker 33cm	ml	126		
4	2.206	Kasete shkarkimi	cupe	8		
SHUMA II						
PUNIME SHITESASHI PER DYSHEME						
1	2.2	Shtrese lluster cimento per nivelim 1:2	m ²	1702		
2	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanaz	m ²	1702		
3	2.324a	plintues pllaka grez	ml	1176		
4	2.267/1	Veshje me pllaka gresq. porc. muret WC	m ²	151.2		
5	2.273	Shtrese me pllaka mermeri lyra e shkolles	m ²	47		
6	2.273	Shtrese me pllaka mermeri ne shesh pushime t=2cm	m ²	46		
7	2.196/c	Hidroizolim WC me dy shtresa mapej - ose ekuivalent me te ne - dysHEME + muret	m ²	151.2		
SHUMA III						
PUNIME SUVATIMI, LYERJE DHE VESHJE						
1	2.3	Sava solete h = 4 m me drejtues, me krah	m ²	1655		
2	2.31	Sava brenda mur tulle h=4m me krah, llac perzier M 25	m ²	3356.8		
3	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rryze + sava.	m ²	999.54		
4	2.328	Patimim i mureve brenda me allici (stakol)	m ²	1655		
5	2.404/1	Lyerje brenda me lloje hidropplastike cilesi e pare	m ²	5011.8		
6	An-N.10	Korimimo metalike tip kangjella dekorative perishi lyerjen	m ²	50		
7	An	Hijezues te jashtem alumini ne fasade	m ²	322		
SHUMA IV						
PUNIME DRITARE DHE DYER						
1	2.273.2b	F.V. Davaqale mermeri i-2cm nen dritare	m ²	41.4		
2	AN - 2.375/1	F.V. Dritare duralumini plastike me dopio sham	m ²	234.26		
3	2.395	F.V. Dyer d-alumini plastike me 1/2 sham (nyje sanitare eej)	m ²	11.97		
4	Analize	F.V. Dyer te brendeshme shkollesh	m ²	83.64		
5	2.386/2	Dyer te jashtme	m ²	7.2		
SHUMA V						
PUNIME PER PALESTREN						
1	2.276	Shtrese parket druri = shtrese niveluse + plintusa	m ²	257		
2	An	Vizime me boje ne krahin sportive (parket)	m ²	58		
3	2.334	Suvatim i mureve te jashteme h = mbi 4m	m ²	265		
4	2.331	Suvatim i mureve te jashteme h = der 4m	m ²	240		
5	2.308/a	Suvatim me suva grafito	m ²	504		
6	2.196	Hidroizolim me rreze tete guapne 4mm + prajmer	m ²	332		
7	2.312	Suvatim i mureve te brendeshme h = mbi 4m	m ²	726		
8	2.326	Veshje me pllaka geramike ne nyje sanitare	m ²	50		
9	2.324/b	plintusa me pllaka grez	ml	60		
10	2.383/1	F.V.Dyer druri MDP me kase demise	m ²	10		
11	2395	F.V.Dyer duralumini 1/2 sham ne nyje sanitare	m ²	8		
12	2.375/a	F.V.Dritare duralumini me sham dopio	m ²	80		
13	2.404	Lyerje tavane me boje hidromat vetajroses	m ²	120		
14	2.404	Lyerje muret e brendeshme me boje plastike	m ²	726		
SHUMA VI						
SISTEME TE JASHTME						
PUNIME GERMIMI DHE MBUSHJE						
1	3.104/b	Germim dheu per kasonetin me eskavator h=50cm	m ³	50		
2	2.375b	Transporti materiale rreftimi, dheu me auto deri 10.0 km	m ³	50		
3	An 164/1a	Mbushje me cetele e gur garore perhapur e ngjeshur me makineri	m ³	20.8		

4	2.426/6	Prishje strukturave ekzistuese betoni	m ²	10		
Punime shesh dhe trotuar						
1	3.244/1	Shtrese b/a, C20/25, t=10cm	m ²	120		
2	2.166	F.V hekur betoni periodik ø - 10mm, (per sheshin trotuar, shkallet, murin dhe stolat)	ton	11,5		
3	3.245/1	F.V bordura , betoni 15X25cm (struktura te holla)	m ²	17		
4	3.238	Shtrese betoni nen bordura, C6/10	m ²	10		
5	An	Shterim me pllaka guri	m ²	1200		
6	3.643	Mbajtelje bari ne kulshite	m ²	200		
7	2.19	Hedhje, rrafshim, mbushje dhe me krah, kategoria III	m ²	100		
8	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative	cope	20		
9	2.181	F.V konstruksione metalike te perbera (porte e jashtme metalike+kanqjella)	ton	3,2		
10	2.401	Boje vaji mbi sipërfaqe metalike (dy duar)	m ²	200		
11	3.244	Mur Betoni C20/25	m ²	56,4		
SHUMA VII						
PUNIME HIDRAULIKE						
Furnizimi me uje nga rrjeti						
1	Analize	F.V Tubo PE - HD Ø 75x6,8 mm, PN16	mi	5		
2	Analize	F.V Rakorderi (brylla, tl, reduksion, etj)	kompl	1		
3	2.494/6	F.V Valvol nderprerese me sfere DN 65 (21/2")	cope	2		
4	Analize	F.V Filter uji me rrjete DN 65, Pn 6 bar	cope	1		
5	Analize	F.V Mates uji DN 65, Pn 6 bar	cope	1		
6	Analize	F.V Valvol moskthimi DN 65, Pn 6 bar	cope	1		
Sistemi i shperndarjes se ujit sanitar						
1	Analize	F.V Tubo PE - HD Ø 75x6,8 mm, PN16	mi	12		
2	Analize	F.V Tubo PE -Xa, DN 50 (ø263 X 8,6) mm	mi	15		
3	Analize	F.V Tubo PE -Xa, DN 40 (ø250 X 5,9) mm	mi	13		
4	Analize	F.V Tubo PE -Xa, DN 32 (ø240 X 5,5) mm	mi	8,5		
5	Analize	F.V Tubo PE -Xa, DN 25 (ø232 X 4,4) mm	mi	10		
6	Analize	F.V Tubo PE -Xa, DN 20 (ø225 X 3,5) mm	mi	2,5		
7	Analize	F.V Tubo PE -Xa, DN 15 (ø20 X 2,8) mm	mi	2,5		
8	Analize	F.V Tubo PE -Xa, DN 12 (ø16 X 2,2) mm	mi	3,5		
9	Analize	F.V Rakorderi PE-Xa (brylla, tl, reduksion, etj)	kompl	3		
10	Analize	F.V Termozolim armoflex per tubo PE-Xa, DN 15 (ø20 X 2,8) mm	mi	2,5		
11	Analize	F.V Termozolim armoflex per tubo PE-Xa, DN 12 (ø16 X 2,2) mm	mi	3,5		
12	2.494	F.V Minivalvula nderprerese per pajisjet sanitare Ø 1/2"	cope	4,5		
Lidhjet hidraulike tek depozitat e ujit						
1	2.492	F.V Tubo celiku zingato dhe rakorderi Ø 3"	kg	30		
2	2.492	F.V Tubo celiku zingato dhe rakorderi Ø 21/2"	kg	40		
3	2.492	F.V Tubo celiku zingato dhe rakorderi Ø 2"	kg	5		
4	2.492	F.V Tubo celiku zingato dhe rakorderi Ø 11/2"	kg	6		
5	2.494/6	F.V Valvol nderprerese me sfere DN 65 (21/2")	cope	2		
6	2.494/4	F.V Valvol nderprerese me sfere DN 40 (11/2")	cope	8		
Shkarkimi i brendshem i ujrave te zeza						
1	Analize	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d110	mi	25		
2	Analize	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d75	mi	60		
3	Analize	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d50	mi	75		
4	Analize	F.V Brylla RAU - PP d110 α = 45°	cope	20		
5	Analize	F.V Brylla RAU - PP d50 α = 45°	cope	20		
6	Analize	F.V Reduksion RAU - PP d110/d75	cope	5		
7	Analize	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d125	cope	5		
8	Analize	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d110	cope	5		
9	Analize	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d75	cope	5		
10	Analize	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d50	cope	10		
11	Analize	F.V Brag 45° d125/110	cope	10		
12	Analize	F.V Brag 45° d110/75	cope	15		
13	Analize	F.V Brag 45° d75/50	cope	15		
Shkarkimi i jashtem i ujrave te zeza						
1	2.1	F.V Gernim dhe transport dhe per kanalet e tubove dhe puseteve	m ²	4,5		
2	2.261	F.V Shtrese rere + transport	m ²	5		
3	Analize	F.V Puseta betoni (60 x 60) cm, me kapak gize	cope	5		
4	Analize	F.V Tubo shkarkimi PE d125	mi	8		
5	Analize	F.V Tubo shkarkimi i mukosur PEHD d160	mi	40		
6	Analize	F.V Tubo shkarkimi i mukosur PEHD d200	mi	50		
7	Analize	F.V Tubo shkarkimi i mukosur PEHD d250	mi	5		
8	Analize	F.V Rakorderi per tubo PEHD (Brylla, reduksione, braga, manikota, etj.)	kompl	1		
Sistemi i drenazhimit te ujrave te shiut						
1	2.1	F.V Gernim dhe transport dhe per kanalet e tubove dhe puseteve	m ²	18,5		
2	2.261	F.V Shtrese rere + transport	m ²	15		
3	Analize	Pusete shkarkimi b/a, 50 x 50 cm, h = 100 cm	cope	10		
4	Analize	F.V Pilete Ø110 per shkarkimin e ujrave te terraces	cope	8		
5	Analize	F.V Varange Ø110 per shkarkimin e ujrave te terraces	cope	8		
6	Analize	F.V Tubo GMY shkarkimi Ø 110 mm	mi	11,5		
7	Analize	F.V Tubo PEHD I magjstralit I rruzhosur Ø 125 mm	mi	9,5		
8	Analize	F.V Tubo PEHD I magjstralit I rruzhosur Ø 160 mm	mi	7,6		

9	Analize	F.V Tubo PEHD I magjistralit I rrudhosur Ø 200 mm	ml	79		
10	Analize	F.V Tubo PEHD I magjistralit I rrudhosur Ø 250 mm	ml	5		
11	Analize	F.V Element ndihmes dhe rakorderi per tuba PEHD	kompl	1		
12	Analize	F.V Tubo I rrudhosur (CORRUGATED), I perbonuar 2200 per drenazhimin e urave nantokesore te themeleve. D 250mm, SN8 I kompetuar me te gjitha aksesoret	ml	35		
Stacioni i pompimit automatik te ujit						
1	An.11	F.V Rezervuar zingato per furnizimin me uje, kapaciteti 5 000 lit, De=1600 mm, H=2660 mm, lidhjet 1½".	kompl	3		
2	Analize	F.V Grupi i furnizimit me uje + paneli elektrik (INVERTER) - Prruja: 19 m³/h, - Prevalenca: 60 mKH2O, - Fuqja elektrike: 2x5.5 kW, rryma 2x10 A, - Ushqimi: 3F/400V/50Hz, - Lidhjet: DN 65, PN 16	kompl	1		
3	Analize	E kompletuar me te gjitha aksesoret e nevojshem. F.V Autoklave 500 l Presioni max. i punes: 16 bar Presioni i ngarkimit: 1.5 bar Kapaciteti: 500 lit Diametri: 650 mm Lartesia: 1865 mm Lidhjet: 1½" (DN 32)	cope	1		
Makineri e pajisje hidrosanitare						
1	An - 15	F.V Boiler elektrici 100 lit, tip horizontal + aksesoret hidraulike	cope	1		
2	An - 16	F.V Boiler elektrici 12 lit + aksesoret hidraulike	cope	5		
3	2.495	F.V Lavaman tualeti + mishelator	cope	5		
4	2.504	F.V WC- alla turka + kuti shkarkuese	cope	5		
SHUMA VIII						
PUNIME ELEKTRIKE						
Rrjeti fuqise. Furnizimi i kuadrove						
1	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 1x185mm, Cu (panel kryesor)	ml	240		
2	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 1x75mm, Cu (Gjenerator)	ml	75		
3	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (Pompa e dozimit)	ml	55		
4	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x10mm, Cu (Kali per dhe)	ml	5		
5	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (Kali pare)	ml	12		
6	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (Kali dyte)	ml	13		
7	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x10mm, Cu (K.lab. Informatikes)	ml	35		
8	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x16mm, Cu (K.Kaldaja)	ml	55		
9	analize	F.V. Kablo te TU , Un=0.6/1 KV ; tip RG7R ; S = 5x10mm, Cu (Palestra)	ml	32		
Kuadri kryesore ne katin per dhe KK						
1	analize	F.V. Kuadri kryesor Kk,metalk, komp.me kit zbara 250A & aksesor 3m, me dim 850/2000/400 mm. IK08 me porte me xham.	cope	1		
2	analize	F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	2		
3	analize	F.V. Instrumenta mates A,V	cope	2		
4	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip NSX 250, In=160A/4P kl. C ; Icc=16 KA, Un=400V	cope	1		
5	analize	F.V. Change over 1600A	cope	1		
6	analize	F.V. Automat magneto-termik, In=63 A/4P kl. C ; Icc=10 KA, Un=400V	cope	1		
7	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial, tip C120N, In=40A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=400V	cope	4		
8	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=25A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1		
9	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=20A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	5		
10	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	2		
11	analize	F.V. Moreseta "Neuter - Toke" per kuadrin kryesor	cope	2		
12	analize	F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1		
Kuadri kryesore ne katin per dhe KK						
1	analize	F.V. Kuadri plastik, komp.me kit zbara 63A & aksesor B/M, me dim 54Module	cope	1		
2	analize	F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	3		
3	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial, tip C40N, In=32A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1		
4	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial, tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	20		
5	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1		
6	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=10A/1P, kl. C ; Icc=10 KA, Un=400V	cope	32		
7	analize	F.V. Leshues 16A, 2P	cope	1		
8	analize	F.V. Rele Bistabel, 220V	cope	1		
9	analize	F.V. Moreseta "Neuter - Toke" per kuadrin e katit te dyte	cope	1		
10	analize	F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1		
Kuadri kryesore ne katin e pare						
1	analize	F.V. Kuadri plastik, komp.me kit zbara 63A & aksesor B/M, me dim 54Module	cope	1		
2	analize	F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	3		
3	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial, tip C40N, In=32A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1		
4	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial, tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	20		
5	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1		
6	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=10A/1P, kl. C ; Icc=10 KA, Un=400V	cope	32		
7	analize	F.V. Leshues 16A, 2P	cope	1		

8	analize	F.V. Rele Bistabel, 220V	cope	1		
9	analize	F.V. Morseta "Neuter - Toka" per kuadrin e kalit te dyte	cope	1		
10	analize	F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1		
Kuadri I kaldajes						
1	analize	F.V. Kuadri plastik, komp.me kit zbara 63A & aksesor BM, me dim 54Module	cope	1		
2	analize	F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	3		
3	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C 120N, In=40A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=400V	cope	1		
4	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C 120N, In=32A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=400V	cope	2		
5	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=25A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	3		
6	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=20A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	1		
7	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	3		
8	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	3		
9	analize	F.V. Leshues 16A, 2P	cope	1		
10	analize	F.V. Rele Bistabel, 220V	cope	1		
11	analize	F.V. Morseta "Neuter - Toka" per kuadrin e Boiler	cope	1		
12	analize	F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1		
Kuadri I Palestres						
1	analize	F.V. Kuadri plastik, komp.me kit zbara 40A & aksesor BM, me dim 54Module	cope	1		
2	analize	F.V. Llamba sinjalizimi me siguresa te brendshme 3w, 220V	cope	3		
3	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C 120N, In=32A/4P kl. C ; Icc=6 KA, Un=400V	cope	1		
4	analize	F.V. Automat magneto-termik diferencial , tip C40N, In=16A/2P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	11		
5	analize	F.V. Automat magneto-termik, tip C40N, In=16A/1P kl. C ; Icc=6 KA, Un=220V	cope	3		
6	analize	F.V. Leshues 16A, 2P	cope	1		
7	analize	F.V. Rele Bistabel, 220V	cope	1		
8	analize	F.V. Morseta "Neuter - Toka" per kuadrin e palestres	cope	1		
9	analize	F.V. Montim kuadri, morseteri, kabllime, kanalina, aksesore etj.	set	1		
Sistemi i fuqise, ndricimit dhe sinjalizimit						
1	analize	F.V. Percjelles i veshur, flex. j.k.z. ; S=1,5 mm2	ml	6000		
2	analize	F.V. Percjelles i veshur, flex. j.k.z. ; S=2,5 mm2	ml	2500		
3	analize	F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,K.Z. FG7-OR ; S=3x4 mm2	ml	700		
4	analize	F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,K.Z. FG7-OR ; S=3x2.5 mm2	ml	600		
5	analize	F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,K.Z. FG7-OR ; S=3x1.5 mm2	ml	400		
6	analize	F.V. Kabell monitor SVGA 20m M/FHD15 (per dalje videoprojektor)	ml	125		
7	analize	F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 13) dj = 16mm	ml	2500		
8	analize	F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 16) dj = 20mm	ml	100		
9	analize	F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 20) dj = 25mm	ml	1100		
10	analize	F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 28) dj = 32mm	ml	600		
11	analize	F.V. Frut ceses 1 polare , 10A	cope	80		
12	analize	F.V. Frut ceses devjat. & invert 10A	cope	3		
13	analize	F.V. Buton tasto komandimi 1P - 16 A ; 250 V ; modulare	cope	3		
14	analize	F.V. Prize 1 fazore + nulifikim (bivalente) 16A	cope	90		
15	analize	F.V. Prize " Schucko " 16A te bardha	cope	20		
16	analize	F.V. Prize 2 " Schucko " 16A dy module te bardha	cope	15		
17	analize	F.V. Prize 2 " Schucko " 16A dy module te kuqe	cope	10		
18	analize	F.V. Prize TV	cope	2		
19	analize	F.V. Kuti per catesa e priza 3-module, suport , kapak & tapa ne mure	cope	120		
20	analize	F.V. Kuti per catesa e priza 4-module, suport , kapak & tapa ne mure	cope	40		
21	analize	F.V. Kuti shperndarese b/m. me kapak PT-2-4 dim. 150*100*50 mm	cope	42		
22	analize	F.V. Rele me dy gjendje Finder, In=16 A, Un=250 V	cope	3		
Sistemi i fuqise, ndricimit dhe sinjalizimit						
1	analize	F.V. Ndricuesa luminishent , FL 4x18w, IP 20	cope	160		
2	analize	F.V. Ndricuesa luminishent , FL 2x 36w, IP 65 ambient teknik	cope	20		
3	analize	F.V. Ndricuesa luminishent , FL 1x60w, IP 40	cope	12		
4	analize	F.V. Ndricuesa luminishent , FL 1x 40w, IP 65 PAR, tualet	cope	60		
5	analize	F.V. Ndricuesa luminishent IP-40,FL 1x 8w (me mbishkrimin dalje) bat.NICdme autonomi 2 ore	cope	10		
6	analize	F.V. Ndricuesa emergjence, IP-40,FL 1x 8w bat.NICdme autonomi 2 ore	cope	10		
7	analize	F.V. Ndricuesa per pasqyre 1x35 tualet	cope	53		
8	analize	F.V. Ndricues tip prozhektor IP 65 JM-TS 150W per fasaden kryesore	cope	6		
9	analize	F.V. Ndricues tip prozhektor 150W per palestren	cope	25		
10	analize	F.V. Rack 19", 42U	cope	1		
11	2.a-98	F.V. Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn ⁺ 30x3mm	ml	240		
12	2.a-73	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e hakerizuar , L=1.5m	cope	20		
13	2.a-97	F.V. Percjelles bakri cu i zhveshur 1x16	ml	15		
14	AN.17	F.V. Shtrize rruferprites, tub zingato Ø=20mm, H=50cm, per mbrojtjen nga soditet atmosferike	cope	5		
SHUMA IX						
SISTEMI I NGROHJES						
Punime Instalimi						
1	2.493/1	F.V Tubo celiku i zi pategel (Mannesmann) Ø 3"	kg	227		
2	2.493/1	F.V Tubo celiku i zi pategel (Mannesmann) Ø 2½"	kg	493		
3	2.493/1	F.V Tubo celiku i zi pategel (Mannesmann) Ø 2"	kg	170		
4	2.493/1	F.V Tubo celiku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1½"	kg	656		

5	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1½"	kg	650		
6	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1"	kg	270		
7	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø ¾"	kg	45		
8	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø ½"	kg	65		
9	Analize	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 3" x 13 / 20 mm, per dy tipe termoizolimesh brenda / jashte, te veshura me flete PVC (brenda) dhe me flete alumin (jashte)	ml	30		
10	Analize	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 2½" x 13 / 20 mm, per dy tipe termoizolimesh brenda / jashte, te veshura me flete PVC (brenda) dhe me flete alumin (jashte)	ml	85		
11	Analize	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 / 20 mm, per dy tipe termoizolimesh brenda / jashte, te veshura me flete PVC (brenda) dhe me flete alumin (jashte)	ml	37		
12	Analize	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me flete PVC	ml	202		
13	Analize	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me flete PVC	ml	445		
14	Analize	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1" x 9 mm, i veshur me flete PVC	ml	122		
15	Analize	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø ¾" x 9 mm, i veshur me flete PVC	ml	32		
16	Analize	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø ½" x 9 mm, i veshur me flete PVC	ml	58		
Rjeti i tubave te bakrit UNI EN 1057						
1	Analize	F.V Tub Cu te perkulshem me termoizolim Ø 14 x 1.0 mm, UNI EN 1057	ml	1500		
2	Analize	F.V Tub Cu te perkulshem me termoizolim Ø 12 x 1.0 mm, UNI EN 1057	ml	250		
3	Analize	F.V Rakorderi bakri (bryla,ti, reduksione etj)	kompl	1		
4	Analize	F.V Elektroda saldimit bronzi - lidhje argjendi L - Ag5	kg	5		
5	Analize	F.V Pastro deoksiduese per saldimit (kuti - 250 gr)	cope	3		
Ambienti teknik per prodhimin e ujit te ngrohte						
1	Analize	F.V Grupi i mbushjes automatike	kompl	1		
2	Analize	F.V Oxhaku - Shtrese lesh xhami me trashesi 25 cm	m ²	15		
3	Analize	F.V Kanal i tymrave me llamarinë çeliku, mbi shtresen izoluese 250/300 mm	kg	220		
4	Analize	F. Oxhak çeliku inox/baker me dopio panel 250/300 mm, pajisur me te gjithë aksesorët	kompl	1		
5	Analize	F.V Kolektorët e dergim / kthim: Øe 114.3 mm (Ø 4")	kompl	2		
6	Analize	F.V Valvul flutur DN 80, Pn 6 bar	cope	10		
7	Analize	F.V Valvul flutur DN 65, Pn 6 bar	cope	6		
8	Analize	F.V Valvul flutur DN 32, Pn 6 bar	cope	4		
9	Analize	F.V Valvol moskthimi DN 80, Pn 6 bar	cope	1		
10	Analize	F.V Valvol moskthimi DN 65, Pn 6 bar	cope	2		
11	Analize	F.V Filter uji me rret DN 80, Pn 6 bar	cope	1		
12	Analize	F.V Filter uji me rret DN 65, Pn 6 bar	cope	2		
13	Analize	F.V Xhunto antivibruese DN 80	cope	4		
14	Analize	F.V Xhunto antivibruese DN 65	cope	4		
15	Analize	F.V Valvul sigurie DN 25, Pn 6 bar	cope	1		
16	Analize	F.V Valvul mishelatrice tredregeshe DN 65	cope	2		
17	Analize	F.V Termometer (0÷120°)	cope	10		
18	Analize	F.V Manometer	cope	10		
19	Analize	F.V Ajernxjemes automatik	cope	20		
20	Analize	F.V Presostat sigurie	cope	1		
21	Analize	F.V Plusostat DN80	cope	1		
22	Analize	F.V Sensor temperature	cope	5		
23	Analize	F.V Sensor i temperatures se ambientit te jashtem	cope	1		
24	Analize	F.V Kabeli transmitemi (2 x 1.5) mm ²	ml	150		
25	Analize	F.V Rregullator klimatik elektronik me mikrorcesor	cope	1		
SHUMA X						
SISTEMI I MBROJTJES KUNDER ZJARRIT						
Materiali i Instalimi						
1	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 3" x 3.65 mm, me mberthime Victaulic	kg	20		
2	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2½" x 3.25 mm, me mberthime Victaulic	kg	200		
3	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2" x 3.25 mm, me mberthime Victaulic	kg	10		
4	2.493/1	F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 1½" x 2.90 mm, me mberthime Victaulic	kg	13		
5	2.494/4	F.V Valvol nderperese me sferë DN 40 (1½")	cope	4		
6	Analize	F.V Rakorderi çeliku i zi (Bryla, TI, reduksione etj). Mberthimi i rakordereve do te behet me kapje Victaulic	kg	15		
7	Analize	F.V Mberthime te rakordereve me kapje Victaulic	cope	25		
Sinjalistika & kodi indeksimit						
1	Analize	F.V Hidrant zjarrm Kodi AI - 5212	cope	4		
2	Analize	F.V Fikëse zjarrm me karrel Kodi AI - 5243	cope	1		
3	Analize	F.V Fikëse zjarrm me pluhur Kodi AI - 5204	cope	12		
4	Analize	F.V Fikëse zjarrm me CO2 Kodi AI - 5206	cope	2		
5	Analize	F.V Buton sinjalizimi i zjarrit Kodi AI - 5102	cope	4		
6	Analize	F.V Lidhja me motopompen Kodi AI - 5121	cope	1		
7	Analize	F.V Zbritje shikalle Kodi AI - 5103	cope	8		
8	Analize	F.V Pirezik zjarrm nga pajisjet elektrike nën tension	cope	2		
9	Analize	F.V Ndërmim i shuarjes së zjarrit me uje	cope	2		
10	Analize	F.V Dalje emergjence	cope	4		

11	Analize	F.V Drejtim i dalje së emergjences Kodi AI - 5107	cope	15		
SHUMA XI						
G - MAKINERI E PAISJE (HIDROSANTARE, NGRUHJE, MBROJTJE NGA ZJARRI)						
SISTEMI I MBROJTJES KUNDER ZJARRIT						
Sinjalistika & kod indeksimit						
1	Analize	F.V Kaset + hidrant zjarri i brendshëm. Kasetë brenda murit, lamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 - UNI 9227, me baze rezine. Dimensionet (370x510x190) mm, tub fleksibel 30 m, Aksesorët: saraqineske ndërprerëse 1½", lançe + zorrë uj DN 45. Pjesa e përparme e mbyllur me çeliks.	kompl	4		
2	Analize	F.V Grupi i lidhjes me motopompe për hidrant DN 65. Vendosja në kasetë të jashtme, lamarine çeliku të emaluar në ngjyrë, të kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2" (DN 50) materiali i grupit bronz.	kompl	1		
3	An - 12	F.V rezervuari zingato 2000 ltra	cope	3		
Stacioni i Pompave të Zjarrit , i kompletuar me panel elektrik etc.						
1	Oferte	F.V Pomp e mbrojtjes kunder zjarrit (2x3) kW, In ~2x10.2 A, 3F- 400V-50Hz - Pnruja (21.6) m ³ / h, Prevalenca 50 mkH2O - Presioni punes 6 bar, presioni max 16 bar Aksesorët Kolektori i dergimit 2½", me flanaxha PN 16 - cope 1 Kolektori i thithjes 2½", me flanaxha PN 16 - cope 1 Valvol ndërprerese me farfalle, gize, PN16, DN 65 - cope 5 Valvol moskthimi, me kllape, flanaxhe PN16, DN 65 - cope 2 Xhunto elastike DN 65 - cope 2 Suporte antivibrues - cope 2 Manometer - cope 2 Manovutometer - cope 2 Presotat per çdo pompe - cope 2 Serhator me mebrane 20 lit , PN 10 - cope 1 Kuader komande e kontrolli per çdo pompe - cope 1	Fuqia e instaluar cope	1		
Fikëse zjarri me bombula						
1	Analize	F.V Fikëse zjarri pluhur kanelato, destinacioni per depoizat e lëndes djegjese, transformatorit. Tip kanelato (e levizshëm). Klasa e zjarrit A-B1-C, kapaciteti normal 50 kg, pesha 82.5 kg, Dim. 500 x 1100 x 600 mm	cope	1		
2	Analize	F.V Fikëse zjarri me pluhur, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshëm). Klasa e zjarrit 55A- 233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartësia 640 mm.	cope	12		
SISTEMI I NGRUHJES						
Radiatorët						
1	Analize	F.V Element radiatori alumin, kapaciteti ne ngruhe per cdo element 150 W, interaksi 600 mm, ΔT=50 °C.	cope	18 2		
2	2.494	F.V Valvol ndërprerese ½"	cope	75		
3	Analize	F.V Valvola termostatike e drejte ½"	cope	75		
4	Analize	F.V Valvol detentor ½"	cope	75		
5	Analize	F.V Ajernjemes ½"	cope	75		
6	Analize	F.V Elemente fiksues ne mur	cope	250		
7	Analize	F.V Kolektor shpërndares per radiatorët 3/4" (5+5)x1/2" I kompletuar me vinivalvula dergim kthim, valvula ndërprerese, ne hyrje-dalje, valvol balancuese, valvol zonale dy kalimshe, ajernjemes, valvula shkarkim, kuti montimi, dhe element te nevojshem montimi.	kompl	2		
8	Analize	F.V Kolektor shpërndares per radiatorët 1" (4+4)x1/2" I kompletuar me vinivalvula dergim kthim, valvula ndërprerese, ne hyrje-dalje, valvol balancuese, valvol zonale dy kalimshe, ajernjemes, valvula shkarkim, kuti montimi, dhe element te nevojshem montimi.	kompl	1		
9	Analize	F.V Kolektor shpërndares per radiatorët 1" (6+6)x1/2" I kompletuar me vinivalvula dergim kthim, valvula ndërprerese, ne hyrje-dalje, valvol balancuese, valvol zonale dy kalimshe, ajernjemes, valvula shkarkim, kuti montimi, dhe element te nevojshem montimi.	kompl	1		
10	Analize	F.V Kolektor shpërndares per radiatorët 1" (9+9)x1/2" I kompletuar me vinivalvula dergim kthim, valvula ndërprerese, ne hyrje-dalje, valvol balancuese, valvol zonale dy kalimshe, ajernjemes, valvula shkarkim, kuti montimi, dhe element te nevojshem montimi.	kompl	4		
11	Analize	F.V Kolektor shpërndares per radiatorët 1" (11+11)x1/2" I kompletuar me vinivalvula dergim kthim, valvula ndërprerese, ne hyrje-dalje, valvol balancuese, valvol zonale dy kalimshe, ajernjemes, valvula shkarkim, kuti montimi, dhe element te nevojshem montimi.	kompl	2		
Pompat, ene zgjerimi ndares hidraulik						
1	Analize	F.V Kaldaje çeliku (grup termik), lenda e qepjetime ashtu druri - kapaciteti Q=465 kW - lidhjet DN80 - zaja e ozahut 0x250 mm. Dimensionet 8xLxH 1200x5038x3360 mm, me pompe anti-kondense te incorporuar, e pajisur me te gjithe komponentet e sigurise dhe kontrollë si dhe aksesorët e nevojshem.	kompl	1		
2	Analize	F.V Pompe qarkullimi teke per qarkun primar INVERTER(kaldaja) - pnruja 38.5 m ³ /h; - prevalenca 60 kPa; - lidhjet DN 65, Pn 6; - fuqia elektrike 1.5 kW, rryma 4.8 A; - ushqimi 3F/400V/50Hz.	cope	1		
3	Analize	F.V Pompe qarkullimi binjake e terminaleve INVERTER - pnruja 17.5 m ³ /h; - prevalenca 120 kPa; - lidhjet DN 65, Pn 6; - fuqia elektrike 2x1.5 kW, rryma 2x5.4 A; - ushqimi 1F/230V/50Hz.	cope	1		
4	Analize	F.V Pompe qarkullimi binjake e terminaleve INVERTER - pnruja 13.5 m ³ /h; - prevalenca 120 kPa; - lidhjet DN 65, Pn 6; - fuqia elektrike 2x1.5 kW, rryma 2x5.4 A; - ushqimi 1F/230V/50Hz.	kompl	1		

5	Analize	F.V Pompe dozimi, me sistem dozimi konstant nga 0% deri ne 100 %; te cilat sherbejne per trajtimin e ujit per sistemin e ngrohjes. Parametrat jane: - Rregullim konstant nga 0-3 lth - Injektimi: 0.36 cc - Kundra presion max.: 7 bar - Temperatura e ambientit: 5°C - 50°C - Voltazhi: 230 V - Fuqia elektrike: 12 W - Mates uji: DN65 4 impulse - 100 lit - Sebrator polietileni: 200 Lit	cope	1		
6	Analize	F.V Nderes hidraulik, per ndarjen e qarkut primar nga qarku sekondar: - Materiali i trupit: çelik; - Presion maksimal i punes: 10 bar; - Temperatura: 0 + 100°C - Lidhjet me flanxha: DN 80 - Lidhja me kundra flanxh: UNI 2278	cope	1		
7	Analize	F.V Ene zgjerimi me diafragme per linjat e terminaleve ngrohjes te godines ekzistuese, dhe palestres Volumi 80 lit Diametri 400 mm Lartesia 820 mm P,max 6 bar T,punes -10+99°C Lidhja Ø3/4"	cope	1		
8	Analize	F.V Ene e zgjerimit te kaldesjes eshte: - Kapaciteti: 200 ltra; - Dimensionet: 600 mm; - Lartësia: 812 mm; - Presioni maksimal: 6 bar; - Temperatura e sistemit: -10°C deri ne +99°C; - Lidhja: Ø3 1/2".	cope	2		
SHUMA XII						
SHUMA TOTALE ZBATIM						
FONDI REZERVE 5%						
SHUMA						
TVSH						
VLERE TOTALE (ME TVSH)						

III.12.2. Bazuar në pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, KPP me nr.1248/3 prot, datë 11.06.2024, iu drejtua autoritetit kontraktor për të vënë në dispozicion të KPP-së dokumentacionin si vijon: *“Me qëllim vijimin e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesave ju duhet të dërgoni në Komisionin e Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, duke përfshirë procesverbalin e përlllogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit dhe preventivin me çmime shoqëruar me analizën teknike të zërave të preventivit që mbajnë shënimin anash (Analizë/An). Gjithashtu, ju duhet të dërgoni edhe përlllogaritjen analitike për fuqinë punëtore dhe mjetet e kërkuara nga ana juaj, mbi bazën e preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve.”*

III.12.3 Në pikën 6 të “Njoftimi i shkurtuar i kontratës për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike”, është përcaktuar: 6. Fondi limit: 97,431,542 (Nëntëdhjetë e shtatë milion, e katërqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e dyzetë e dy) Lekë pa TVSH.

III.12.4. Në nenin 34, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor në fazën e hartimit të nevojave të tyre për mallra, punë, shërbime mbajnë në konsideratë metodat e përlllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përlllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale përpara dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.”*

Ndërsa në nenin 35 “Studimi paraprak i tregut” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Përpara se të nisnin një procedurë prokurimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.

Për këtë qëllim, autoriteti ose enti kontraktor mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin

dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës.

2. Në çdo rast duhet të shmangët rreptësisht çdo konflikt interesi ose edhe shfaqja e një konflikti interesi në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik.

3. Parashikime të detajuara për këtë proces përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.12.5. Në nenin 13, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Për studimin e tregut, autoriteti/enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbalisht, grupi i ngritur për këtë qëllim, harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës. Autoriteti/enti kontraktor, duhet të kujdeset që konsultimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të shmangë dhënien e çdo informacioni preferencial, që mund të favorizojë operatorë të caktuar në përgatitjen e ofertës për procedurën e prokurimit.”*

III.12.6. Në nenin 1, pika të VKM-së nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, përcaktohet se: *“1. Krijimin e sistemit të integruar të informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim (në vijim “sistemi i integruar”), i cili unifikon metodologjinë e llogaritjes e të formatit të paraqitjes së preventivave dhe situacioneve, si dhe të analizave teknike të çmimeve për të lehtësuar veprimtarinë e subjekteve publike apo private, si dhe për lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar në fushën e ndërtimit.”*

Në nenin 5, të VKM-së nr.216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” përcaktohet se: *“Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programim të fondeve publike nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, për të përcaktuar vlerën e fondit limit të veprës orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuar në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit.”*

Në nenin 6, të VKM-së nr.216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” përcaktohet,: *“Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”*

Ndërsa në nenin 7 të aktit nënligjor më sipër, përcaktohet: *“Preventivat për çdo objekt, të hartuara nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në faqen e preventivave të unifikuar në portalin unik qeveritar e-Albania, sipas metodologjisë së*

Ilogaritjes së kostos, janë pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo të ndërtuar në Republikën e Shqipërisë.”

III.12.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se: *“Kodet e zërave të preventivit në SPE nuk janë përshtatur me kodet e manualit në fuqi, por janë bazuar në manualin e vjetër, çka na bën të dyshojmë se fondi limit nuk është saktë”* dhe nga shqyrtimi i materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ dhe konkretisht preventivi me çmime i dërguar nga autoriteti kontraktor në KPP përmes shkresës me nr. 1936 prot., datë 12.06.2024 protokolluar me tonën me nr. 1248/4 prot., datë 18.06.2024, nga verifikimi rezulton, se një pjese e zërave të preventivit ka mospërputhje me VKM-në nr. 216, datë 13.4.2023, *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”*, e cila shfaqet në tre drejtime: Në mospërputhje mes çmimit të zërave në preventiv sipas kodeve përkatëse, me çmimin/njësi të këtyre zërave sipas manualit të aktit nënligjor më sipër dhe konkretisht evidetojmë disa prej zërave me këtë problematikë si: 2.212/b *“Ulluk shkarkimi horizontal me baker 33 cm, 2.37/5b “Transport materiale ndërtimi dheu me auto deri 10.0 km”* 2.166 *“ F.V hekur betoni periodik +10mm (për sheshin trotuar, shkallët, murin dhe stolat”* 3.238 *“shtresë betoni me bordura, c 6/10”*, 3.643 *“Mbjellje bari në lulishte”*, 2.401 *“Bji vaji me siperfaqe metalike (dy duar)”*, 3.244 *“Mur betoni C20/25”* etij; Në mospërputhje mes çmimit/njësi dhe emërtimit të zërave të përcaktuar në preventiv sipas kodeve përkatëse, me çmimin/njësi dhe emërtimin e këtyre zërave sipas manualit të aktit nënligjor më sipër dhe konkretisht evidetojmë disa prej zërave me këtë problematikë si: 3.104/b *“germim dheu për kasoneten me eskavator h50 cm”* 2.426/5 *“Prishje e strukturave ekzistuese betoni”* 3.245/1 *“F.V bordura betoni 15x25 cm (struktura te holla), 2.426/5 “Prishje struktura ekzistuese betoni”*; Në mospërputhje mes emërtimit të përcaktuar në preventiv sipas kodeve përkatëse me emërtimin sipas manualit në aktin nënligjor më sipër dhe konkretisht evidetojmë disa prej zërave me këtë problematikë si: 2.383/1 *“F.V dyer druri F.V MDF me akse derrase”*, 2.375/a *“F.V dritare duralumini me xham dopio”* 2.404, *“Lyerje tavane me boje hidromat vetajroses”*, 2.334 *suvatim i mureve të jashtme h=mbi 4 m”* 2.331 *“Suvatim i mureve të jashtme h=deri 4 m”* 2.312 *“Suvatim i mureve të brendshme h=mbi 4”*. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimuesit dhe mënyrës së hartimit të preventivit, si për sa i përket emërtimit të zërave, ashtu edhe çmimeve/njësi të tyre, KPP vëren, se ka një standard të miratuar me një akt nënligjor si VKM nr. 216, datë 13.4.2023 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar, për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”*, i cili ka vendosur krijimin e sistemit të integruar të informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim (në vijim *“sistemi i integruar”*), i cili unifikon metodologjinë e llogaritjes e të formatit të paraqitjes së preventivëve dhe situacioneve, si dhe të analizave teknike të çmimeve, për të lehtësuar veprimtarinë e subjekteve publike apo private, si dhe për lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar në fushën e ndërtimit. Në nenin 5 akti nënligjor i sipërcituar, ka përcaktuar qartë se: *““Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programim të fondeve publike nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, për të përcaktuar vlerën e fondit limit të veprës orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuar në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit.”* Për të vazhduar më tej me nenin 6 të tij në të cilin përcaktohet se: *“ Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo*

punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.” Duke e analizuar në këtë këndvështrim dhe pas njohjes me zërat e preventivit dhe çmimet përkatëse të tyre, KPP vëren, se autoriteti kontraktor, për disa prej zërave që KPP ka marrë në shqyrtim, vihet re në disa raste mospërputhja e cituar më lart në emërtim, në çmim/njësi, ose si në emërtim dhe në çmim/njësi me ato të përcaktuara në VKM-në më sipër. Për sa kohë që hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim, duke gjetur rregullim të posaçëm përmes aktit më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa që t’i qëndrojnë strikt këtij rregullimi dhe të hartojë preventivin me kodet, emertimin dhe çmimet/njësi siç parashikon akti nënligjor më sipër. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasisë përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij, specifikimet teknike të tyre, preventivin për llojin e mallit/shërbimit/punës, me zërat përkatës, e në vijim të tyre, duke përcaktuar edhe fondin limit për një objekt të caktuar prokurimi. Në këtë kuadër, duke marrë në konsideratë që vetëm disa prej zërave të preventivit që KPP mori në shqyrtim (pa analizuar të gjithë preventivin) nxirrin në pah mospërputhje mes preventivit të hartuar nga autoriteti kontraktor dhe manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim të rregulluar përmes VKM nr.216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, përbëjnë arsye të mjaftueshme për të gjykuar, se fondi limit i procedurës së prokurimit nuk është hartuar saktë. Si i tillë, duke qenë se ai përbën një ndër elementet thelbësore të një procedure prokurimi, KPP gjykon, se kjo procedurë duhet anuluar. Me rihapjen e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa që të hartojë preventivin e punimeve me kodet, emertimet dhe çmimet/njësi përkatëse, saktësisht siç është parashikuar në VKM nr.216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Sa më lart, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.13. Lidhur me ankesën e paraqitur pranë KPP, më datë 21.05.2024, me nr. 1249/2 prot., nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK përmes shërbimit postar, KPP vëren, se përveçse ajo është paraqitur në kundërshtim me parashikimet e nenit 111 “Paraqitja e ankesës” pika 1, paragrafi i parë i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”, gjithashtu është edhe jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 110, pika 1 e LPP, i cili parashikon, se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit

kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës 14.05.2024, dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është 14.05.2024, ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimuesi pranë autoritetit kontraktor përmes shërbimit postar, është data 21.05.2024, jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Sa më lart, ankesa e paraqitur pranë KPP më datë 21.05.2024, me nr. 1249/2 prot., nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK përmes shërbimit postar, nuk pranohet.

III.14. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Lluca” SHPK, i cili kërkon që: “- *Kategoria NP-2 Ndertime civile dhe industriale klasifikimi C, te modifikohet dhe te behet NP-2 klasifikimi A; - Kategoria NP-7 klasifikimi B te modifikohet dhe te behet NP-7 klasifikimi A;- Kategoria NS-9 klasifikimi B, kerkojme heqjen e ketij kriteri kualifikimi.*” pretendime të cilat nuk janë pranuar nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon, se referuar arsyetimit më sipër të KPP, preventivi i punimeve, së bashku me çmimet e disa prej zërave të punimeve, do të ndryshojë duke u përmbytur në hartimin e tij, saktësisht në manualin e përcaktuar në VKM nr.216, datë 13.4.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” dhe në këtë kuadër ato nuk do të merren në shqyrtim, pasi KPP nuk mund të gjykojë mbi themelin e pretendimeve të ankimuesit, për sa kohë që shqyrtimi i tyre ka lidhje të drejtpërdrejtë me zërat dhe çmimet e përcaktuara në preventiv.

Sa më lart, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Lluca” SHPK dhe “Kevin Konstruksion” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-04512-05-13-2024, me objekt “Rikonstruksion i Gjimnazit ‘Skënderbeu’, Has” me fond limit 97,431,542 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.05.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Has.
2. Të pranojë pjesërisht ankesat e operatorëve ekonomikë “Lluca” SHPK dhe “Kevin Konstruksion”, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

3. Të mos pranojë ankesën e “Kevin Konstruksion” SHPK, të paraqitur në KPP përmes shërbimit postar, më datë 21.05.2024, me nr. 1249/2 prot.
 4. Autoriteti kontraktor, të anulojë procedurën e prokurimit dhe me rihapjen të ketë parasysht konstatimet e mësipërme të KPP.
 5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Luca” SHPK dhe “Kevin Konstruksion” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

